

MISIONI NDËRKOMBËTAR PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE Republika e Maqedonisë së Veriut, Zgjedhjet lokale, 19 tetor 2025

DEKLARATË PËR GJETJET DHE PËRFUNDIMET PARAPRAKE

PËRFUNDIMET PARAPRAKE

Zgjedhjet lokale të 19 tetorit ishin konkurruese, duke u ofruar votuesve një zgjedhje të vërtetë nga një spektër i gjerë alternativash politike, por ato u zhvilluan në një ambient politik shumë të polarizuar, duke përfshirë edhe përgjatë vijave etnike, dhe në një sfond të zhgënjimit me politikën dhe të perceptimeve të përhapura për korrupsion. Edhe pse administrata zgjedhore në përgjithësi i menaxhoi përgatitjet zgjedhore në mënyrë efikase, mospërputhjet dhe boshllëqet në legjislacionin zgjedhor, si dhe burimet e kufizuara dhe infrastruktura e vjetëruar, ndikuan negativisht në disa aspekte të punës së saj. Liritë themelore u respektuan kryesisht dhe kandidatët patën mundësi të bënin fushatë në mënyrë të lirshme, por rastet e keqpërdorimit të burimeve publike dhe akuzat për presion dhe frikësim të votuesve ishin shqetësuese. Edhe pse kandidatët bënë fushatë kryesisht për çështjet komunale, procesi, i udhëhequr kryesisht nga partitë politike, u karakterizua nga debate në nivel kombëtar mbi identitetin, integritimin në BE, korrupsionin dhe të drejtat e bashkësive etnike për përfaqësim të barabartë. Dispozitat ligjore për reklamimin politik, duke përfshirë edhe atë në media, i vunë në disavantazh kandidatët e pavarur dhe partitë joparlamentare dhe i përjashtuan padrejtësisht partitë më të vogla me një grup parlamentar. Transparenca e financimit të fushatës u ndikua negativisht nga mangësitë sistemore në legjislacion dhe kapacitetet dhe kompetencat e kufizuara zbatuese të organeve mbikëqyrëse. Gratë mbetën të nën-përfaqësuara në jetën publike dhe politike, dhe barazisë gjinore iu kushtua vëmendje e kufizuar gjatë fushatës. Dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht e qetë dhe e rregullt, por u vunë re disa mangësi procedurale.

Korniza ligjore ofron një bazë teknike për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike. Megjithatë, ajo përmban boshllëqe të shumta dhe i mungon qartësia në disa fusha, gjë që nganjëherë ka shkaktuar interpretime të ndryshme. Megjithëse ndryshimet e Kodit Zgjedhor të vitit 2024 trajtuan disa kongreseve rekomandime të mëparshme të ODIHR-it dhe Kongresit, shumica e tyre mbeten të patrajtuara. Përveç kësaj, në maj të vitit 2025, Gjykata Kushtetuese i shfuqizoi dispozitat mbi numrin e nënshkrimeve mbështetëse për kandidatët e pavarur, mirëpo parlamenti nuk arriti të plotësojë boshllëkun ligjor në kohë për ta plotësuar kornizën ligjore. Më pas, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) e rregulloi këtë çështje duke kërkuar vetëm nënshkrimet e dy qytetarëve. Edhe pse kjo ndërhyrje e KSHZ-së u konsiderua e nevojshme për të rregulluar një aspekt të rëndësishëm të procesit zgjedhor, ajo krijoi një precedent që potencialisht e sfidon parimin e ndarjes së pushteteve, në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së.

Administrata zgjedhore, në përgjithësi, veproi brenda afateve kohore ligjore dhe i menaxhoi përgatitjet në mënyrë efikase. Ajo e gëzonte besimin e publikut, por u shprehën disa shqetësime në lidhje me pavarësinë e saj, pasi përbëhet kryesisht nga zyrtarë publikë. KSHZ-ja para këtyre zgjedhjeve plotësoi disa vende pune të cilat kishin mbetur të pa plotësuar për një kohë të gjatë, duke përfshirë atë të sekretarit të përgjithshëm, me qëllim të përmirësimit të kapacitetit të saj administrativ. Disa operacione zgjedhore, duke përfshirë përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillave Zgjedhorë (KZ), u ndikuan negativisht nga mungesa sistematike e investimeve afatgjata në kapacitetet dhe modernizimin e KSHZ-së. KSHZ-ja mbajti mbledhje në bazë *ad hoc*, të cilat u transmetuan online dhe u publikuan në faqen e saj të internetit; megjithatë, media, vëzhguesit dhe përfaqësuesit e autorizuar të garuesve u ftuan përmes listave të brendshme në vend të shpalljeve publike, gjë që zvogëloi transparencën.

Ligji u garanton të drejtën e votës të gjithë qytetarëve të moshës 18 vjeç e lart, përveç atyre që u është hequr e drejta juridike me vendim përfundimtar të gjykatës. Kufizimi i të drejtës së votës në bazë të aftësisë së kufizuar intelektuale ose psiko-sociale është në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe me standardet e tjera ndërkombëtare. Regjistri i votuesve (RV) ishte i hapur për këqyrje publike, duke përfshirë edhe nga kandidatët zgjedhorë. Çështjet e kahershme, duke përfshirë numrin e madh të votuesve që jetojnë jashtë vendit në vend të vendbanimit të tyre të përhershëm sipas Regjistrit të votuesve (RV), si dhe sistemin e paplotë dhe të vjetëruar të adresave të banimit, ndikuan negativisht në saktësinë e RV-së dhe në pjesëmarrjen e votuesve. Rreth 1,72 milionë qytetarë me vendbanim të përhershëm në vend u përfshinë në listat e votuesve.

Në një proces, përgjithësisht gjithëpërfshirës, Komisionet Zgjedhore Komunale (KZK) regjistruan gjithsej 577 lista këshilltarësh, me ç'rast të gjitha e përmbushën kuotën gjinore, dhe 309 kandidatë për kryetar komune, nga të cilët vetëm 32 ishin gra, si dhe refuzuan regjistrimin e 6 kandidatëve për kryetar komune dhe 4 listave të këshillave. Pavarësisht rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it, individëve që vuajnë ose presin ekzekutimin e një dënimi me burg prej më shumë se gjashtë muajsh vazhdon t'u ndalohet e drejta për të kandiduar për poste zyrtare. Verifikimi i dosjeve penale të kandidatëve përmes gjykatave themelore rezultoi i rëndë dhe, nganjëherë, shkaktoi vonesa.

Liritë themelore u respektuan dhe, në përgjithësi, kandidatët kishin mundësi të zhvillonin fushatë në mënyrë të lirshme. Fushata ishte konkurruese dhe votuesve u ofroi një diapazon të gjerë alternativash politike. Edhe pse rregulla të rrepta që vlejnin nga dita e shpalljes së zgjedhjeve dhe që synojnë parandalimin e keqpërdorimit të burimeve publike ose keqpërdorimit të detyrës zyrtare, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MVZ) i ODIHR-it vuri në dukje se si para ashtu edhe gjatë periudhës zyrtare të fushatës, kryetarët e komunave dhe funksionarët e lartë qeveritarë përuruan, vizituan ose promovuan projekte investimesh dhe infrastrukture, duke i minuar në mënyrë efektive këto masa ligjore mbrojtëse. Aktivitetet e fushatës të bartësve të funksioneve publike nuk janë të rregulluara, dhe funksionarët qeveritarë, duke përfshirë kryeministrin, promovuan në mënyrë aktive kandidatët lokalë në mbarë vendin. Edhe pse nuk përbënin shkelje të ligjit, praktikat e tilla e zbehën vijën ndarëse midis shtetit dhe partisë, në kundërshtim me paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990. Shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it pretenduan se është bërë presion mbi punonjësit e sektorit publik dhe se janë frikësuar votuesit dhe kandidatët e opozitës, si dhe se ka pasur blerje votash nga partitë politike, duke i synuar veçanërisht komunitetet romë të cënueshme ekonomikisht. MVZ-ja e ODIHR-it vuri në dukje disa raste të retorikës nxitëse dhe sulme *ad hominem*, si dhe një numër shumë të vogël të rasteve të izoluara të dhunës.

Zhvillimi i fushatës në rrjetet sociale, duke përfshirë reklamimin e paguar politik dhe fushatat e palëve të treta nuk është i rregulluar në mënyrë të veçantë. Asnjë autoritet mbikëqyrës nuk ka mandat për të monitoruar fushatën në rrjetet sociale, për të zbuluar dezinformatat, përmbajtjet manipuluese ose sjelljen e koordinuar joautentike, gjë që ngre shqetësime. Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale hartoi një Kod vullnetar të Sjelljes në Hapësinë Online gjatë Proceseve Zgjedhore dhe Referendumeve, por vetëm nëntë garues zgjedhorë e nënshkruan atë. Kandidatët dhe partitë politike e fokusuan fuqishëm aktivitetin e tyre në rrjetet sociale, duke zhvilluar fushatë aktive në Facebook që nga fillimi i periudhës zyrtare të fushatës. Toni i përdorur në rrjetet sociale u bë gjithnjë e më akuzues në fazat përfundimtare të fushatës, dhe u vunë re disa raste të retorikës nxitëse. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it raportuan ngacmime online, duke përfshirë nga llogari të rreme, si dhe sulme mizogjine.

Për fat të keq, gratë vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuara në jetën publike dhe politike, duke përfshirë edhe në nivel lokal. Presidentja aktuale është grua, dhe gratë përbëjnë 40 për qind të deputetëve, por vetëm 3 nga 23 ministrat e qeverisë dhe 2 nga 81 kryetarët e komunave të zgjedhur në vitin 2021 janë gra. Ligji përcakton një kuotë gjinore prej 40 për qind për listat e kandidatëve, me kërkesa specifike për renditjen e tyre dhe obligon që secila gjini të përfaqësohet me të paktën 30 për qind në komisionet

zgjedhore. Diskutimet mbi barazinë gjinore dhe të drejtat e grave kryesisht mungonin në platformat dhe fjalimet e fushatës së kandidatëve. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it shprehën shqetësime në lidhje me retorikën mizogjine kundër kandidateve gra dhe pjesëmarrjes politike të grave në përgjithësi, veçanërisht në internet.

Fondet publike përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të financimit të përgjithshëm të fushatës. Korniza ligjore që e rregullon financimin e fushatës përmban boshllëqe sistemore dhe shumica e rekomandimeve të ODIHR-it që kanë të bëjnë me financimin e fushatës mbeten të patrajtuara. Në kombinim me kapacitetin e kufizuar të organeve mbikëqyrëse, kjo e pengoi mbikëqyrjen efektive të financimit të fushatës. Fushatat mund të financohen nga burime publike dhe private. Megjithatë nuk ka financim të drejtpërdrejtë publik për fushatën, partitë politike që marrin fonde nga shteti mund t'i përdorin ato për qëllime të fushatës. Ligji vendos kufizime për donacionet dhe shpenzimet, ndalon burime të caktuara të financimit dhe përcakton sanksione për shkeljet në financimin e fushatës. Kandidatët duhet të dorëzojnë raporte financiare të përkohshme dhe përfundimtare, por vetëm raportet përfundimtare i nënshtrohen revizionit, gjë që e zvogëloi transparencën. Pothuajse dy të tretat e pjesëmarrësve nuk i dorëzuan fare raportet e tyre të para të përkohshme, që është në kundërshtim me ligjin.

Kushtetuta e garanton lirinë e shprehjes dhe të mediave, dhe Kodi Zgjedhor kërkon që mediat t'i mbulojnë zgjedhjet në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme. Megjithatë, kërkesat për të ofruar mbulim të barabartë të kandidatëve rezultuan sfiduese, duke pasur parasysh numrin e lartë të garuesve dhe kapacitetin e kufizuar të shumicës së mediave. Reklamimi politik në media, duke përfshirë edhe në ato online, kompensohet nga buxheti i shtetit me një formulë të shpërndarjes që favorizon ndjeshëm partitë kryesore parlamentare, ndërkohë që u mohon mundësi domethënëse partive më të vogla dhe kandidatëve të pavarur, dhe nuk ofron as fonde e as kohë transmetimi për partitë më të vogla me grup parlamentar. Organi rregullator i mediave vuri re disa pabarazi në mbulimin mediatik, por nuk raportoi ndonjë shkelje të ligjit nga ana e mediave. Transmetuesit kombëtarë e përmbushën detyrimin e tyre ligjor në lidhje me qasshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në programet e tyre. Monitorimi i mediave nga MVZ-ja e ODIHR-it tregoi se mbulimi i çështjeve zgjedhore në mediat transmetuese gjatë fushatës ishte përgjithësisht i balancuar.

Përderisa kundërshtimet që lidhen me zgjedhjet, si rregull, mund të parashtrohen në komisionet zgjedhore dhe në gjykata, rregullimi i zgjidhjes së kontesteve zgjedhore përmban paqartësi dhe boshllëqe, duke përfshirë afate kontradiktore dhe kompetenca të paqarta institucionale. Baza ligjore që u mundëson votuesve të parashtrojnë kundërshtime mbetet e kufizuar, gjë që është në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare. Ligji parashikon afate të shkurtra për parashtrimin dhe shqyrtimin e kundërshtimeve, gjë që mund ta dëmtojë cilësinë e vendimeve. Gjykata Kushtetuese shqyrtoi disa iniciativa në lidhje me këto zgjedhje dhe i hodhi poshtë të gjitha, ndërsa Gjykata Administrative shqyrtoi katër kundërshtime para ditës së zgjedhjeve, duke i konfirmuar vendimet e KSHZ-së dhe të KZK-ve për refuzimin e kandidaturave. Ndërkohë që kontestet në përgjithësi u trajtuan në mënyrë efikase, në përputhje me procedurat dhe brenda afateve të përcaktuara, shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it ngritën shqetësime në lidhje me paanshmërinë dhe pavarësinë e organeve gjyqësore, veçanërisht për sa i përket kontesteve të mundshme mbi rezultatet e zgjedhjeve.

Kodi Zgjedhor parashikon si vëzhgimin vendas ashtu edhe atë ndërkombëtar të zgjedhjeve, duke përfshirë edhe nga përfaqësuesit e autorizuar të garuesve. Në një proces gjithëpërfshirës, KSHZ-ja akreditoi 807 vëzhgues qytetarë nga 20 organizata dhe 644 vëzhgues ndërkombëtarë nga 21 organizata. Aktivitetet e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat qytetare vëzhguese ishin minimale për shkak të mungesës së financimit. Në vend të kësaj, ato u përqendruan në monitorimin e mediave dhe rrjeteve sociale, ndikimet e mundshme të huaja keqdashëse dhe fushatat e dezinformimit, keqpërdorimin e burimeve shtetërore, marrëdhëniet ndërmjet bashkësive dhe qasshmërinë e procesit zgjedhor.

Dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht e qetë dhe e rregullt, dhe procedurat u respektuan në përgjithësi. Vëzhguesit e MNVZ-së e vlerësuan votimin pozitivisht në 98 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, por raportuan mangësi procedurale, të tilla si votim në grup dhe ndërhyrje të panevojshme nga përfaqësuesit e kandidatëve, si dhe disa çështje që lidhen me fshehtësinë e votës dhe probleme me identifikimin biometrik të votuesve. Fatkeqësisht, më shumë se gjysma e qendrave të votimit të vëzhguara nuk ofruan mundësi për hyrje të pavarur për votuesit me aftësi të kufizuara fizike. Shumica dërmuese e numërimit të votave që u vëzhguan nga MNVZ-ja u vlerësuan pozitivisht në përgjithësi, me vlerësime negative kryesisht për shkak të mosrespektimit të shpeshtë të procedurave të parapara dhe gabimeve procedurale. Vëzhguesit e MNVZ-së e vlerësuan pozitivisht nxjerrjen e rezultateve në shumicën e KZK-ve të vëzhguara, megjithatë raportuan hapësira të papërshtatshme, mbipopullim dhe disa mangësi procedurale. Në katër komuna, zgjedhjet për kryetar komune do të duhet të përsëriten pasi në zgjedhje morën pjesë më pak se një e treta e votuesve të regjistruar.

GJETJET PARAPRAKE

Sfondi dhe konteksti politik

Më 9 gusht, Kryetari i Parlamentit i shpalli zgjedhjet lokale për 19 tetor, me mundësi për zhvillim të rrethit të dytë të zgjedhjeve për kryetar komune më 2 nëntor, për të zgjedhur kryetarët e komunave dhe këshillat në 80 komuna dhe në Qytetin e Shkupit.

Ambienti politik është dominuar prej kohësh nga Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) dhe Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë (LSDM), të cilat kanë udhëhequr qeveri në mënyrë alternuese në koalicion me Bashkimin Demokratik për Integritet (BDI) të shqiptarëve etnikë dhe parti më të vogla. Në zgjedhjet e fundit lokale në vitin 2021, koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja mori kontrollin e shumicës së komunave, ndërsa LSDM-ja pësoi humbje të mëdha, gjë që çoi në dorëheqjen e kryeministrit të atëhershëm Zoran Zaev. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, VMRO-DPMNE-ja fitoi numrin më të madh të deputetëve dhe formoi një qeveri me VLEN-in, një koalicion i partive politike etnike shqiptare, dhe “Për Maqedoninë Tonë” (ZNAM). Në zgjedhjet e njëkohshme presidenciale, Gordana Siljanovska-Davkova, e mbështetur nga VMRO-DPMNE-ja, u zgjodh në rrethin e dytë si gruaja e parë presidente e vendit.¹

Këto zgjedhje lokale u zhvilluan në një ambient të polarizuar politik. Diskursi publik u përqendrua në çështjet e identitetit kombëtar, të drejtat e bashkësive etnike, dhe debatet mbi ndryshimet kushtetuese në pritje dhe reformat e qeverisjes që nevojiten për përparimin në negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE). Çështjet legjislative që i prekin bashkësitë etnike, duke përfshirë shqyrtimin ende të pashpallur të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve nga Gjykata Kushtetuese, si dhe shqetësimet lidhur me përfaqësimin e drejtë në institucionet publike, përbënin gjithashtu një sfond të rëndësishëm. Pakënaqësia publike ndaj institucioneve në të gjitha nivelet dhe perceptimet për korrupsion të përhapur vazhduan të jenë të pranishme.² Shumë bashkëbisedues të Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të ODIHR-it vunë në dukje se pas zjarrit tragjik në një klub nate në Koçan në mars të vitit 2025,

¹ Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja siguroi 58 mandate deputetësh, BDI-ja dhe koalicioni i udhëhequr nga LSDM-ja fituan nga 18 mandate, VLEN-i fitoi 14 mandate, ndërsa ZNAM-i dhe “Levica” fituan nga 6 mandate.

² Shih [Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të vitit 2024](#) të “Transparency International” dhe [Raportin për Vlerësimin e Korrupsionit në Maqedoninë e Veriut të vitit 2023](#) të Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe raportin [Besimi i Përgjithshëm dhe Besimi në Institucione të vitit 2024](#); dhe [Raportin e Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut të vitit 2024](#).

perceptimet për përgjegjësi të pamjaftueshme dobësuan më tej besimin e publikut ndaj institucioneve.³ Shqetësimet ekzistuese lidhur me respektimin e pavarësisë së gjyqësorit u thelluan pas thirrjeve të fundit të qeverisë për shkarkime në Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin e Prokurorëve.⁴

Për fat të keq, gratë mbeten të nën-përfaqësuar në jetën publike dhe politike, duke përfshirë edhe në nivel lokal. Gratë aktualisht kanë 48 nga 120 mandate deputetësh (40 për qind), vetëm 3 nga 23 poste ministore (13 për qind) dhe vetëm 2 nga 81 pozicione të kryetarëve të komunave. Pavarësisht Ligjit për Mundësi të Barabarta për Gratë dhe Burrat të vitit 2006 dhe Strategjisë Kombëtare për Barazi Gjinore 2022-2027 të miratuara nga Kuvendi, bashkëbiseduesit e theksuan mungesën e përpjekjeve kuptimplote për promovimin e grave brenda strukturave udhëheqëse të partive, duke potencuar se stereotipet e vazhdueshme gjinore, përfaqësimi i kufizuar në media dhe mungesa e mbështetjes financiare dhe organizative vazhdojnë të pengojnë pjesëmarrjen e plotë politike të grave.

Sistemi zgjedhor dhe korniza ligjore

Këshilltarët lokalë dhe kryetarët e 80 komunave dhe të Qytetit të Shkupit zgjidhen drejtpërdrejt për një mandat katërvjeçar. Kryetarët e komunave zgjidhen sipas sistemit të shumicës me dy rrethe zgjedhore. Nëse asnjë kandidat nuk fiton shumicën absolute të votave të hedhura në rrethin e parë, dy javë më vonë mbahet një balotazh mes dy kandidatëve që kanë fituar më shumë vota. Zgjedhjet për kryetar komune janë të vlefshme nëse të paktën një e - treta e votuesve të regjistruar në komunë marrin pjesë në rrethin e parë; përndryshe, zgjedhjet duhet të përsëriten brenda 60 ditëve, pa kërkesë për pjesëmarrje të votuesve.⁵ Këshilltarët zgjidhen përmes sistemit proporcional, me lista të mbyllura, pa prag të përcaktuar. Listat e kandidatëve për këshillat komunalë duhet të përfshijnë të paktën 40 për qind kandidatë nga secila gjini, me kërkesa specifike për renditjen e tyre.⁶ Numri i këshilltarëve përcaktohet në bazë të popullsisë së komunës, dhe mund të jetë nga 9 deri në 33 këshilltarë, ndërsa 45 anëtarë zgjidhen në Këshillin e Qytetit të Shkupit.⁷

Zgjedhjet lokale rregullohen kryesisht nga Kushtetuta e vitit 1991, Kodi Zgjedhor i vitit 2006, si dhe aktet nënligjore të miratuara nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ). Ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor, të miratuara pak para zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale të vitit 2024 nëpërmjet një procedure të përshpejtuar pa debat publik dhe pa konsultim me palët kryesore të interesuara, trajtuan disa rekomandime të mëparshme të ODIHR-it, duke përfshirë qartësimin e afatit kohor dhe kushteve për përsëritjen e zgjedhjeve për kryetar komune. Megjithatë, shumë rekomandime mbeten të pazbatuara, duke përfshirë ato që lidhen me sigurimin e qasjes së barabartë në media gjatë fushatave zgjedhore, rritjen e llogaridhënies dhe integritetit të financimit të fushatave, si dhe përforcimin e rregullave për keqpërdorimin e burimeve administrative.

³ Më 16 mars 2025, në një zjarr në një klub nate në Koçan humbën jetën 63 persona dhe u lënduan të paktën edhe 192 të tjerë. Klubi i natës kishte shkelur disa rregullore të sigurisë dhe disa zyrtarë qeveritarë u arrestuan si pjesë e hetimit për lëshimin e licencës së tij. Pas ngjarjes, shpërthyen protesta afatshkurtra kundër korrupsionit në të gjithë vendin, ndërsa protestat javore në Koçan vazhdojnë.

⁴ Më 6 shkurt të vitit 2025, kryeministri Hristijan Mickoski [bëri thirrje](#) për shkarkime në Këshillin Gjyqësor. Pas këtyre thirrjeve, më 11 mars, Parlamenti votoi për kërkesat për interpelancë kundër disa anëtarëve të Këshillit Gjyqësor. Shih gjithashtu [Raportin e Komisionit Evropian për Sundimin e Ligjit për vitin 2025](#).

⁵ Në rast se nuk zgjidhet një kryetar komune, qeveria do të emërojë një përfaqësues për të ushtruar detyrën dhe brenda 15 ditëve do ta njoftojë Kryetarin e Parlamentit, për të shpallur zgjedhje të reja për kryetar komune. Kërkesa për pjesëmarrje të votuesve nuk zbatohet për rrethin e dytë të mundshëm të zgjedhjeve për kryetar komune ose për zgjedhjet e këshillave komunalë.

⁶ Një nga çdo tre pozicione në listë duhet të jetë i plotësuar me një kandidat të gjinisë më pak të për

Në maj të vitit 2025, duke vepruar mbi iniciativën e një grupi votuesish, Gjykata Kushtetuese shfuqizoi dispozitat e Kodit Zgjedhor që kërkonin që kandidatët e pavarur në zgjedhjet parlamentare dhe lokale të mbledhnin nënshkrime mbështetëse nga një për qind e votuesve të regjistruar në njësinë zgjedhore përkatëse. Gjykata konstatoi se, sipas kësaj formule, numri i kërkuar i nënshkrimeve në 37 nga 80 komunat dhe në Qytetin e Shkupit do të ishte dukshëm më i lartë se në zgjedhjet e mëparshme lokale, duke krijuar kushte të pabarabarta (shih *Të drejtat e kandidatëve dhe regjistrimi i tyre*). Më 16 gusht, një javë pas shpalljes së zgjedhjeve, tre deputetë propozuan një ndryshim të Kodit Zgjedhor me qëllim të adresimit të boshllëkut ligjor që rezultoi nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese; megjithatë kjo iniciativë nuk u miratua në parlament.⁸

Në përgjithësi, korniza ligjore ofron një bazë teknike për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike. Megjithatë, ajo përmban boshllëqe të shumta dhe është e paqartë në disa fusha kyçe, gjë që herë pas here ka çuar në interpretime të paqëndrueshme, që nuk janë në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare.⁹ Për më tepër, për shkak të mungesës së shumicës së kualifikuar në parlament për të adresuar këto boshllëqe ligjore dhe për të zbatuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese, KSHZ-ja e rregulloi aspektin që lidhet me numrin e nënshkrimeve për kandidatët e pavarur. Edhe pse kjo ndërhyrje e KSHZ-së u konsiderua e nevojshme për të rregulluar një aspekt të rëndësishëm të procesit zgjedhor, ajo krijon një precedent që potencialisht e sfidon parimin e ndarjes së pushteteve, në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së.¹⁰ Shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it, duke i përfshirë edhe ata nga institucionet shtetërore, e kritikuan praktikën e përsëritur të miratimit të ndryshimeve të vona në Kodin Zgjedhor pa debat ose pa konsultim paraprak, gjë që, sipas tyre, kontribuon në pasigurinë juridike dhe e dobëson stabilitetin e ligjit, duke e theksuar nevojën për reformë gjithëpërfshirëse ligjore.¹¹

Administrata zgjedhore

Zgjedhjet u administruan nga KSHZ-ja, 81 Komisione Zgjedhore Komunale (KZK), duke përfshirë Komisionin Zgjedhor të Qytetit të Shkupit (KZQSh), dhe 3,480 Këshilla Zgjedhore (KZ). Organet zgjedhore duhet t'i përmbushin kriteret ligjore për përfaqësimin gjinor dhe etnik. Secila gjini duhet të përbëjë të paktën 30 për qind të anëtarëve, ndërsa në komunat ku të paktën 20 për qind e qytetarëve i përkasin bashkësive etnike jo-shumicë, këto grupe duhet të përfaqësohen në mënyrë të barabartë.¹²

⁸ Edhe pse 65 deputetë votuan për iniciativën, ajo dështoi pasi nuk siguroi shumicën e dyfishtë të kualifikuar, që kërkohej sipas nenit 69(2) të [Kushtetutës](#), i cili, përveç shumicës së përgjithshme, për ligje të caktuara kërkon gjithashtu që shumica e deputetëve nga komunitetet jo-shumicë të votojnë në favor të propozimit. Paragrafi II.B.6 i [Deklaratës Interpretuese të Rishikuar mbi Stabilitetin e Legjislacionit Zgjedhor](#) të vitit 2024 të Komisionit Evropian për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venedikut) të Këshillit të Evropës parashikon se “pasi të jenë shpallur zgjedhjet, nuk duhet të bëhen ndryshime në legjislacionin zgjedhor, përveç nëse ato janë rreptësisht të nevojshme për të respektuar vendimet detyruese të gjykatave kushtetuese kombëtare”.

⁹ Për shembull, ligji nuk parashikon një dallim të qartë midis garave për kryetar komune dhe atyre për këshilltarë, një formulë gjithëpërfshirëse për shpërndarjen e fondeve shtetërore për qëllime të fushatës, rregulla të qarta për ngjarjet para fushatës, kërkesa të hollësishme për raportimin e financimit të fushatës dhe procedura të qarta për disa lloje kundërshtimesh. Parimi 15 i [Udhëzimeve të ODIHR-it të vitit 2024 mbi Hartimin Demokratik të Ligjeve për Ligje më të Mira](#) parasheh se “ligjet duhet të hartohen në mënyrë të qartë, precize dhe të padyshtimë”. Shih gjithashtu paragrafin 60 të [Listës Kontrolluese për Sundimin e Ligjit](#) të Komisionit të Venedikut të vitit 2016.

¹⁰ Paragrafi 18.1 i [Dokumentit të Moskës të OSBE-së të vitit 1991](#) thekson se “legjislacioni do të formulohet dhe do të miratohet si rezultat i një procesi të hapur që reflekton vullnetin e njerëzve, qoftë drejtpërdrejt ose p

KSHZ-ja është një organ i përhershëm i emëruar nga parlamenti për një mandat pesëvjeçar dhe përbëhet nga shtatë anëtarë, katër të propozuar nga shumica parlamentare dhe tre nga opozita, bazuar në propozimet e partive politike.¹³ Në përputhje me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it, para këtyre zgjedhjeve, KSHZ-ja plotësoi disa vende pune të cilat kishin mbetur pa plotësuar për një kohë të gjatë, duke përfshirë atë të sekretarit të përgjithshëm.¹⁴ Megjithatë, ajo vazhdoi të mbështetej shumë në personel dhe shërbime të përkohshme nga institucione të tjera për shkak të mungesës sistematike të financimit afatgjatë për punonjës dhe për infrastrukturën fizike dhe të TIK-ut. Kjo ndikoi negativisht në efikasitetin e operacioneve zgjedhore dhe e kufizoi aftësinë e KSHZ-së për të përmbushur mandatin e saj në mënyrë të pavarur, pavarësisht rekomandimeve të bëra prej kohësh nga ODIHR-i.¹⁵

Administrata zgjedhore e gëzonte besimin e palëve të interesuara, por u shprehën disa shqetësime në lidhje me pavarësinë e saj, pasi përbëhet kryesisht nga zyrtarë publikë. Në përgjithësi, përgatitjet për zgjedhjet, që ishin nën përgjegjësinë e KSHZ-së, u realizuan pa vonesa të mëdha. Ajo mbajti mbledhje në bazë *ad hoc*, të cilat u transmetuan në YouTube, dhe procesverbalet përgjithësisht u publikuan në faqen e internetit të KSHZ-së.¹⁶ Vendimet e KSHZ-së zakonisht u miratuan unanimisht për shkak të praktikës së konsultimeve paraprake midis anëtarëve të saj. Si rregull, mediat, vëzhguesit dhe përfaqësuesit e autorizuar të garuesve u njoftuan përmes një liste të brendshme, e jo përmes shpalljeve publike, gjë që e kufizoi transparencën dhe paraqiti devijim nga praktikat e mira ndërkombëtare.¹⁷

Edhe pse Kodi Zgjedhor nuk vendos detyrime të veçanta për qasshmërinë përveç caktimit të përgjegjësisë për qasshmërinë e vendotimeve tek autoritetet lokale dhe pronarët e objekteve/hapësirave, KSHZ-ja ofroi disa lehtësira dhe mjete ndihmëse për votuesit me aftësi të kufizuara, duke përfshirë shabllonet e fletëvotimeve me prekje të përshtatura për secilën komunë, kabina të veçanta votimi dhe edukim të votuesve në gjuhën maqedonase të shenjave. Video-klipet për edukimin e votuesve, të prodhuara nga KSHZ-ja, u transmetuan nga transmetuesit kombëtarë, duke përfshirë klipet që i inkurajonin qytetarët të votojnë dhe i informonin votuesit që votojnë për herë të parë.¹⁸

KZK-të përbëhen nga kryetari dhe katër anëtarë të zgjedhur rastësisht nga radhët e punonjësve të shërbimit publik për mandat pesëvjeçar.¹⁹ Në zgjedhjet lokale, KZK-të janë përgjegjëse për

¹³ Kryetari i KSHZ-së zgjidhet nga anëtarët e emëruar nga opozita, ndërsa zëvendëskryetari nga ata që propozohen nga shumica parlamentare. Përbërja aktuale e KSHZ-së, e cila u emërua në vitin 2021, u përshtat në vitin 2025 me zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të ri pas ndryshimit të shumicës parlamentare pas zgjedhjeve të vitit 2024.

¹⁴ Megjithëse sekretarja e përgjithshme e sapoemëruar është grua, KSHZ-ja ende nuk i përmbahet kërkesës për përfaqësim gjinor, pasi vetëm dy nga shtatë anëtarët e saj aktualë janë gra.

¹⁵ Shih paragrafin 62 të [Mendimit të ODIHR-it të vitit 2025 mbi Kodin Zgjedhor të vitit 2006](#).

¹⁶ Për shkak të mungesës së një afati të qartë të qartë për publikim dhe mbledhjeve jo të shpeshta të KSHZ-së në zgjedhjet lokale, publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve nuk bëhej gjithmonë në mënyrë konsekuente dhe të shpejtë. Rregullorja mbi procedurat e brendshme të KSHZ-së parashikon që procesverbalet e mbledhjeve të KSHZ-së të publikohen pasi komisioni të ketë votuar për miratimin e tyre. Disa procesverbale u publikuan me vonesë të konsiderueshme.

¹⁷ Seksioni II.3.1 i [Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore](#) të Komisionit të Venedikut thotë se “mbledhjet e komisionit qendror të zgjedhjeve duhet të jenë të hapura për të gjithë, duke përfshirë mediat”.

¹⁸ Përkthimi në gjuhën e shenjave u ofrua vetëm nga gjuha e folur maqedonase në gjuhën maqedonase të shenjave, pasi përkthyesit

administrimin e procesit në komunat e tyre, duke përfshirë emërimin dhe trajnimin e KZ-ve, verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët potencialë, regjistrimin e garuesve, si dhe nxjerrjen dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve në nivel komunal. KZK-të në komunat me numër veçanërisht të lartë të votuesve dhe vendvotimeve angazhuan personel shtesë për të kompensuar ngarkesën disproporcionale të punës. Pavarësisht zëvendësimeve të shumta të anëtarëve të tyre, duke përfshirë edhe ato që u bënë vonë gjatë procesit, pagesave të papërshtatshme dhe kufizimeve buxhetore, shumica e KZK-ve i menaxhuan përgatitjet zgjedhore në mënyrë efikase. Megjithatë, informacioni i disponueshëm publikisht në lidhje me KZK-të dhe aktivitetet e tyre mbeti i kufizuar, gjë që e zvogëloi transparencën, që është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare.²⁰

Meqenëse mandati i anëtarëve të përhershëm të KZ-ve skadoi para këtyre zgjedhjeve, anëtarët e rinj të përhershëm duhej të zgjidheshin paralelisht me përgatitjet e tjera zgjedhore.²¹ Shumica e KZK-ve raportuan vonesa dhe sfida në këtë proces, që u krye për herë të parë duke përdorur softuerin e KSHZ-së. KZK-të e informuan MVZ-në e ODIHR-it se baza e të dhënave e zyrtarëve publikë ishte e vjetëruar dhe përfshinte persona të papërshtatshëm. Ata gjithashtu theksuan se sistemi, i cili mirëmbahet nga Ministria e Administratës Publike, nuk përmban të dhëna kontakti që do t'u mundësonin KZK-ve të verifikonin menjëherë disponueshmërinë e anëtarëve të përzgjedhur të KZ-ve.²²

Megjithëse me ndryshimet e vitit 2024 u krijua një Qendër për Edukim të Vazhdueshëm Zgjedhor, në përputhje me një rekomandim të mëparshëm të ODIHR-it, njësia për trajnime e KSHZ-së nuk është riorganizuar ende.²³ Gjatë një periudhe 20-ditore, KSHZ-ja trajnoi 27.178 anëtarë të KZK-ve dhe KZ-ve.²⁴ Sesionet e trajnimit të vëzhguara nga MVZ-ja e ODIHR-it ishin përgjithësisht efikase dhe interaktive, përkundër vonesave në miratimin dhe shpërndarjen e disa doracakëve dhe shablloneve që do ta përforconin efektin e të mësuarit.²⁵ Trajnimi nuk trajtoi në mënyrë sistematike ndërveprimin me votuesit me aftësi të kufizuara dhe nuk u zhvillua gjithmonë në gjuhën e popullsisë shumicë të komunës përkatëse.²⁶

Të drejtat e votuesve dhe regjistrimi i tyre

Të gjithë qytetarët e moshës 18 vjeç e lart kanë të drejtë vote, përveç atyre që u është hequr e drejta juridike me vendim përfundimtar të gjykatës në bazë të aftësisë së kufizuar intelektuale ose psiko-sociale. Kufizimi i të drejtës së votës në bazë të aftësisë së kufizuar intelektuale ose psiko-sociale është

²⁰ Neni 10 i [Konventës së Këshillit të Evropës të vitit 2009 për Qasjen në Dokumentet Zyrtare](#) thotë se “autoriteti publik duhet të marrë masat e nevojshme për të bërë publike dokumentet zyrtare që i mban në interes të promovimit të transparencës dhe efikasitetit të administratës publike, si dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen e informuar të publikut në çështje me interes të përgjithshëm”.

²¹ KZ-të, të cilat janë përgjegjëse për administrimin e procedurave të ditës së zgjedhjeve, formohen sipas një modeli të përzier profesional-politik. Tre anëtarë zgjidhen rastësisht nga radhët e punonjësve të sektorit publik për një mandat katërvjeçar, ndërsa një anëtar emërohet nga partitë qeverisëse dhe një nga opozita, të emëruar për çdo zgjedhje. Të gjithë anëtarët e KZK-ve dhe KZ-ve kanë zëvendës, të zgjedhur në të njëjtën mënyrë si edhe përbërja kryesore, të cilët i marrin përsipër të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi në mungesë të tyre.

²² Ministria e Administratës Publike i pranoi këto mangësi, por theksoi se institucionet publike nuk kanë detyrim ligjor për të dorëzuar përditësime të rregullta në ministri.

²³ MVZ-ja e ODIHR-it u informua se qendra ende nuk është krijuar për shkak të kufizimeve financiare dhe mosmarrëveshjeve midis drejtuesve aktualë të KSHZ-së lidhur me statusin e saj në strukturën e përgjithshme të shërbimit teknik të KSHZ-së.

²⁴ Anëtarët e KZ-ve ishin të detyruar të marrin pjesë në trajnime, përndryshe kompensimi i tyre do të ulej për 20 për qind.

në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe me standardet e tjera ndërkombëtare, edhe atë pavarësisht rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it.²⁷

Regjistrimi i votuesve është pasiv dhe i strukturuar sipas komunës së vendbanimit të përhershëm të votuesit. Regjistri i votuesve (RV) mirëmbahet nga KSHZ-ja me ndihmën e Entit Shtetëror të Statistikave. Ligji përcakton se RV-ja bazohet në të dhënat nga regjistri qendror i popullsisë, i cili mirëmbahet nga Ministria e Transformimit Digjital në bashkëpunim me institucione të ndryshme.²⁸ Në praktikë, pavarësisht rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it, KSHZ-ja vazhdon të mbështetet vetëm në të dhënat dhe në përditësimet që i merr nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), pasi sistemi i saj i TI-së nuk është i pajtueshëm me bazat e të dhënave të institucioneve të tjera, gjë që e pengon shkëmbimin automatik të të dhënave.

Qytetarët mund t'i verifikojnë të dhënat e tyre gjatë gjithë vitit në faqen e internetit të KSHZ-së ose personalisht në zyrat rajonale të KSHZ-së. Përveç kësaj, para çdo zgjedhjeje, regjistri i votuesve është i disponueshëm për këqyrje publike për një periudhë prej 18 ditësh, duke filluar 15 ditë pas shpalljes së zgjedhjeve.²⁹ Pas periudhës së këqyrjes publike të, partitë politike kishin mundësinë të kërkonin një kopje elektronike të regjistrit për komunat në të cilat do të garojnë dhe të parashtronin kërkesa për korrigjime deri më 20 shtator.³⁰ Regjistri i votuesve përfshinte 1.832.415 qytetarë me të drejtë vote, ndërsa listat e votuesve të përdorura në ditën e zgjedhjeve përmbanin të dhëna për 1.717.803 votues, duke përfshirë 112.000 votues që banojnë jashtë vendit, 2.162 që janë në paraburgim dhe 450 që gjenden në institucione të kujdesit jashtë komunës së tyre të banimit.³¹

Ligji nuk bën dallim midis zgjedhjeve për kryetar komune dhe zgjedhjeve për këshillat komunale. Prandaj, votuesit u nënshkruan në listat e votuesve vetëm një herë për të marrë dhe për të hedhur dy fletëvotime në shumicën e komunave dhe katër në Qytetin e Shkupit. Ndërkohë që votimi nuk është i detyrueshëm, kjo mënyrë e rregullimit të votimit nuk u lejoi votuesve të zgjidhnin në cilin proces zgjedhor të marrin pjesë, gjë që është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare.³²

Pavarësisht besimit të përgjithshëm të palëve të interesuara në cilësinë e regjistrimit të votuesve, çështjet e kahershme, duke përfshirë numrin e konsiderueshëm të votuesve që jetojnë jashtë vendit në vend të

²⁷ Paragrafi 7.3 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990](#) thekson se “vendet pjesëmarrëse do të... garantojnë votim universal dhe të barabartë për qytetarët moshë rritur”. Shih Nenin 29 të [Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara \(KDPK\) të vitit 2006](#), i cili kërkon që Shtetet Palë t'u “garantojnë personave me aftësi të kufizuara të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato në mënyrë të barabartë me të tjerët”. Paragrafi 9.4 i [Komunikatës Nr. 4/2011 të KDPK-së të vitit 2013](#), thekson se “[...] përjashtimi i të drejtës për të votuar në bazë të paafësisë së perceptuar ose aktuale psiko-sociale ose intelektuale, duke përfshirë kufizimin në bazë të një vlerësimi të individualizuar, përbën diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar”.

²⁸ Ofruesit kryesorë të të dhënave për regjistrin e popullsisë janë Drejtoria për Udhëheqjen e Librave Amë, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Regjistri Qendror.

²⁹ Sipas të dhënave të KSHZ-së, gjatë kësaj periudhe gjithsej 26.393 votues i kontrolluan të dhënat e tyre, duke përfshirë 19.606 që i verifikuan ato në mënyrë elektronike përmes faqes së internetit të KSHZ-së dhe 6.787 që i kontrolluan ato personalisht në zyrat rajonale të KSHZ-së. Në shumicën e komunave, numri i votuesve të regjistruar u ul në krahasim me zgjedhjet lokale të vitit 2021, veçanërisht në Novaci (për 15,31 për qind), Çuçer Sandevë (11,57 për qind) dhe Mogillë (10,09 për qind), ndërsa rritje u regjistrua në Studeniçan (8,15 për qind), Haraçinë (5,57 për qind) dhe Pllasnicë (5,51 për qind).

³⁰ Nga partitë politike dhe garuesit e t

vendbanimit të tyre të përhershëm sipas Regjistrimit të votuesve (RV), si dhe sistemin e paplotë dhe të vjetëruar të adresave të banimit, ndikuan negativisht në pjesëmarrjen e votuesve dhe saktësinë e RV-së. Megjithatë ligji i detyron qytetarët që jetojnë përgjithmonë jashtë vendit të çregjistrohen nga vendbanimi i tyre brenda vendit, ky detyrim rrallë përmbushet.³³ Regjistri i adresave, i cili menaxhohet nga Regjistri Qendror, është një përmbledhje e bazave të të dhënave të adresave të komunave. Në mungesë të mekanizmave të zbatimit ose stimuljeve, shumica e komunave e injoruan kërkesën e Regjistrimit Qendror për të dorëzuar bazat e tyre të të dhënave të përditësuara të adresave, gjë që pengoi një shqyrtim kuptimplotë të tyre dhe i zvogëloi përpjekjet për përmirësimin e saktësisë së të dhënave.³⁴

Të drejtat e kandidatëve dhe regjistrimi i tyre

Qytetarët me të drejtë vote mund të kandidojnë për kryetar komune ose këshilltar, por vetëm në komunën e vendbanimit të tyre të përhershëm.³⁵ Pavarësisht rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it, individëve që vuajnë ose presin ekzekutimin e një dënimi me burg prej më shumë se gjashtë muajsh vazhdon t'u ndalohet e drejta për të kandiduar për poste zyrtare. Ky kufizim është tepër kufizues dhe në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare.³⁶

Kandidatët mund të emërohen nga partitë politike dhe koalicionet, ose nga grupet e votuesve. Për të plotësuar boshllëkun ligjor në lidhje me numrin e nënshkrimeve mbështetëse të nevojshme për kandidatët e pavarur (shih *Sistemi Zgjedhor dhe Korniza Ligjore*), KSHZ-ja miratoi një Rregullore për Mbledhjen e Nënshkrimeve nga Kandidatët e Pavarur, e cila sqaroi se kandidatët e pavarur duhej të mbledhnin vetëm dy nënshkrime mbështetëse. Ky veprim i KSHZ-së, dhe si pasojë, Udhëzimet e KSHZ-së për procedurat e dorëzimit dhe regjistrimit të listave të kandidatëve, u kundërshtuan pa sukses para Gjykatës Kushtetuese.³⁷

Dokumentet e kandidimit duhej të dorëzoheshin te KZK-të dhe KZQSh-ja, me një afat dyditor të dhënë për korrigjimin e mangësive.³⁸ Kodi Zgjedhor, kalendari i aktiviteteve të KSHZ-së dhe aktet e tjera nuk i rregullojnë qartë afatet e ndryshme kohore që zbatohen gjatë verifikimit të listave, gjë që çoi në një

³³ Paragrafi 1.1.6.c i [Kodit të Praktikës së Mirë](#) të Komisionit të Venedikut thotë: “Regjistrimi mund të bëhet aty ku një votues ka vendbanimin e tij ose të saj të dytë, nëse ai ose ajo banon atje rregullisht dhe kjo shfaqet, për shembull, në pagesat e tatimeve lokale; në atë rast, natyrisht, votuesi nuk duhet të jetë i regjistruar aty ku ai ose ajo e ka vendbanimin e tij ose të saj kryesor”.

³⁴ Vetëm 38 nga 80 komuna (47,5 për qind) e bënë këtë. Procesi i reformimit të legjislacionit që lidhet me sistemin e regjistrimit të adresave, i cili filloi në vitin 2016, aktualisht është pezulluar. Shih gjithashtu paragrafin 12 të [Rezolutës 378 \(2015\) të Kongresit të vitit 2015 mbi listat zgjedhore dhe votuesit që de facto banojnë jashtë vendit](#) që thotë: “... rëndësia e një 'lidhjeje të vërtetë', përmes marrëdhënieve mbizotëruese (vendbanimi i përhershëm, interesat qendrore të jetës, etj.), midis një votuesi dhe vendit në të cilin ai/ajo e hedh votën në nivel lokal”.

³⁵ Kufizimi që një kandidat mund të garojë vetëm në komunën e tij ose të saj të banimit të përhershëm është potencialisht joproporcional me qëllimin e ligjit kur zbatohet për komunat brenda qytetit të Shkupit.

³⁶ Paragrafi 24 i [Dokumentit të OSBE-së të Kopenhagës i vitit 1990](#) parashikon se “çdo kufizim i të drejtave dhe lirive në një shoqëri demokratike, duhet të ketë lidhje me një nga qëllimet e ligjit në fuqi dhe të jetë në përpjesëtim të rreptë me qëllimin e ligjit”. Paragrafi 15 i [Komentit të përgjithshëm nr. 25 i KDPC-së së OKB-së i vitit 1996](#) thotë se “personat që përndryshe kanë të drejtë të kandidojnë për t'u zgjedhur nuk duhet të përjashtohen me anë të kërkesave të paarsyeshme ose diskriminuese siç janë arsimit, vendbanimi ose prejardhja, ose për shkak të përkatësisë politike”. Shih gjithashtu Paragrafin 14 të Komentit të Përgjithshëm Nr. 25, i cili thotë se “palët duhet t'i t

zbatim jo të njëtrajtrashëm të procedurave të verifikimit nga KZK-të.³⁹ KZK-të theksuan se verifikimi i dosjeve penale të kandidatëve përmes gjykatave themelore ishte i rëndë dhe se gjykatat shpesh nuk respektonin afatin 24-orësh për këto kontrolle, gjë që shkaktoi vonesa të konsiderueshme në përpunimin e regjistrimeve të kandidatëve dhe, nganjëherë, ndikoi edhe në përgatitjet e tjera zgjedhore.⁴⁰ Megjithatë, të gjitha listat e kandidatëve u verifikuan para afatit të fundit për regjistrimin e kandidatëve dhe para shortit të KSHZ-së që përcakton renditjen e garuesve në fletëvotime.⁴¹

Në një proces gjithëpërfshirës, KZK-të dhe KZQSh-ja regjistruan gjithsej 10,490 kandidatë në 577 lista këshillash komunalë, të parashtruara nga 27 parti politike, 6 koalicione, dhe 65 grupe votuesish. Të gjitha listat e regjistruara të kandidatëve i plotësuan kërkesat e kuotës gjinore. Gratë përbënin 45,1 për qind të të gjithë kandidatëve për këshilla dhe ishin bartëse në 107 lista të kandidatëve (18,5 për qind). Gjithsej u regjistruan 309 kandidatë për kryetar komune, nga të cilët 79 u emëruan nga 19 parti politike, 176 nga 5 koalicione dhe 55 nga grupe votuesish. Gratë ishin dukshëm të nën-përfaqësuar, me vetëm 32 kandidatë për kryetarë komune (10,4 për qind).. MVZ-ja e ODIHR-it është në dijeni vetëm për disa kandidatë me aftësi të kufizuara që garojnë në këto zgjedhje. KZK-të refuzuan gjashtë kandidatë për kryetar komune dhe katër lista këshillash, për shkak të dorëzimit me vonesë ose mangësive në dokumentacion; të gjitha ankesat kundër refuzimeve u hodhën poshtë nga Gjykata Administrative (shih *Zgjidhja e kontesteve zgjedhore*).

Ambienti i fushatës

Periudha zyrtare e fushatës filloi më 29 shtator dhe përfundoi më 17 tetor. Zhvillimi i fushatës para afatit zyrtar, duke përfshirë përdorimin e fondeve të fushatës dhe publikimin e reklamave të fushatës, është i ndaluar; megjithatë, ligji lejon një ngjarje fushate midis regjistrimit të kandidatëve dhe fillimit zyrtar të fushatës. Kjo dispozitë është e paqartë dhe u zbatua në mënyrë jokonsekuente nga garuesit.

Kodi Zgjedhor parashikon qasje të barabartë në fushatë për të gjithë garuesit; megjithatë, 80 për qind e hapësirave për reklamim politik në ambient të jashtëm dhe 90 për qind e fondeve shtetërore për reklamim të paguar politik në media shpërndahen në mënyrë të barabartë midis katër partive kryesore në pushtet dhe atyre në opozitë. Ky rregullim i vë në disavantazh partitë joparlamentare dhe kandidatët e pavarur dhe i përjashton partitë më të vogla politike që kanë grup parlamentar. Për këto zgjedhje, partive “Levica” (e Majta) dhe ZNAM nuk iu caktua asnjë hapësirë për billborde.⁴²

Liritë themelore të bashkimit, tubimit dhe shprehjes u respektuan dhe, në përgjithësi, kandidatët kishin mundësi të zhvillonin fushatë në mënyrë të lirshme. Fushata ishte konkurruese, duke u ofruar votuesve një diapazon të gjerë alternativash politike. Aktivitetet e fushatës varionin nga përpjekjet lokale për

³⁹ Për shembull, Kodi Zgjedhor nuk është i qartë se kur fillon periudha prej 24-orësh për KZK-të për të verifikuar një listë të dorëzuar. Kalendari i aktiviteteve të KZSH-së parashikon se afati fillon në momentin kur lista dorëzohet. Disa KZK-e e informuan MVZ-në e ODIHR-it se kishin marrë udhëzim nga KSHZ-ja se afati 24-orësh fillon nga momenti kur KZK-ja merr përgjigje nga gjykata për dënimet penale të kandidatëve të emëruar.

⁴⁰ Për shembull, KZK-të paralelisht duhej të zgjidhnin anëtarë të rinj të KZ-ve, një proces i ndërlikuar me shumë hapa. Në disa komuna, përzgjedhja e anëtarëve të KZ-ve nuk ishte finalizuar para trajnimeve të planifikuara për ta (shih *Administrata zgjedhore*). Verifikimet e të dhënave penale kryhen nga gjykatat themelore me juridiksion mbi vendlindjen e kandidatëve, dhe nga gjykata themelore e Shkupit për ata që kanë lindur jashtë vendit. Meqenëse informacioni mbi vendin e lindjes në letërnjoftime nuk është gjithmonë i saktë, kjo i detyroi KZK-të t'i kontaktonin drejtpërdrejt kandidatët e mundshëm. Ndryshe nga institucionet e tjera publike që kanë qasje automatike të drejtpërdrejtë në këto të dhëna, KZK-të duhej t'i kërkonin ato manualisht për secilin kandidat. 34 KZK i raportuan MVZ-së së ODIHR-it se kishte vonesa në përpunimin e kërkesave për të dhënat penale në gjykata.

⁴¹ As ligji dhe as ndonjë akt tjetër nuk parashikon procedura të detaju

kontakt me qytetarët deri te tubimet masive të organizuara nga partitë ose koalicionet kryesore.⁴³ Temat kryesore u përqendruan rreth çështjeve lokale, por prezencë të dalluar kishin temat e gjera kombëtare, veçanërisht në lidhje me vizionet konkurruese mbi identitetin kombëtar dhe marrëdhëniet ndëretnike, integrimin në BE, sundimin e ligjit dhe korrupsionin. Fushatat e koalicioneve të udhëhequra nga VMRO-DPMNE-ja dhe LSDM-ja përdorën kryesisht gjuhën maqedonase në ngjarjet e vëzhguara nga MVZ-ja e ODIHR-it dhe në rrjetet sociale, ndërsa koalicioni i udhëhequr nga BDI-ja dhe VLEN-i bënë fushatë si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë maqedonase në disa komuna dhe online.⁴⁴ BDI pretendoi legjitimitet ekskluziv për të përfaqësuar komunitetin shqiptar dhe i paraqiti këto zgjedhje si një referendum mbi këtë çështje, ndërsa VMRO-DPMNE-ja u prezantua si garantuese e dinjitetit kombëtar maqedonas. Garuesit ngritën akuza të ndërsjella dhe u vunë re disa raste të retorikës nxitëse dhe sulme *ad hominem*.⁴⁵ U raportuan një numër shumë i vogël i rasteve të izoluara të dhunës.⁴⁶

Ligji ndalon keqpërdorimin e disa burimeve shtetërore nga dita e shpalljes së zgjedhjeve. Ka një ndalim për përdorimin e zyrove publike, pajisjeve dhe automjeteve zyrtare për qëllime të fushatës.⁴⁷ Ligji gjithashtu ndalon përdorimin e fondeve publike për projekte të reja infrastrukturore dhe për përrurimin e projekteve të financuara nga shteti duke filluar 20 ditë para periudhës zyrtare të fushatës. Si para ashtu edhe gjatë periudhës zyrtare të fushatës, kryetarët e komunave dhe zyrtarët e lartë qeveritarë përruruan, inspektive ose promovuan projekte investimesh dhe të infrastrukturës, në kundërshtim me këto dispozita.⁴⁸ Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it shprehën shqetësime në lidhje me projekte të mundshme të infrastrukturore të planifikuara paraprakisht, të cilat ishin parashikuar të zhvillohen gjatë

⁴³ MVZ-ja e ODIHR-it vëzhgoi 98 ngjarje të fushatës në 42 komuna. Nga 98 ngjarje, në 15 u paraqitën folëse gra, 69 ishin të qasshme për personat me aftësi të kufizuara fizike, dhe vetëm përfshinte interpretim në gjuhën e shenjave. Në ngjarjet e vëzhguara nga MVZ-ja e ODIHR-it, pjesëmarrja e të rinjve ishte mesatarisht 20 për qind, ndërsa gratë përbënin 33 për qind të audiencës.

⁴⁴ Në katër ngjarje të koalicionit të udhëhequr dhe BDI-ja dhe VLEN-i, u përdor si gjuha shqipe ashtu edhe ajo maqedonase. Gjuha turke u përdor në dy ngjarje të vëzhguara, një nga koalicioni i udhëhequr nga BDI-ja dhe një nga VLEN-i.

⁴⁵ Më 28 shtator, në një tubim fushate të mbajtur nga Aleanca Kombëtare për Integrim (AKI) e udhëhequr nga BDI-ja, në ekran u shfaqën video nga konflikti ndëretnik i vitit 2001. Ali Ahmeti, kryetari i BDI-së, duke iu referuar kryeministrit dhe VLEN-it tha: “Kristijan, me zagarë dilet në gjueti për lepuj, jo për shqiponja. Shqiponjat fluturojnë lart - zagarët i ruajnë lepujt”. Po atë ditë, Kryeministri Mickoski u përgjigj: “Kemi një mesazh për Ali Ahmetin: Ti nuk je shqiponjë, por harabel. Në fakt, ju jeni... laraska kriminele dhe të korrumpuar”. Më 10 tetor, në një tubim në Vallandovë, kryeministri tha: “Ne do të donim të garojmë me argumente... me strategji.” Por, me nekrofili të këtillë, nuk mund të konkurrojmë në mënyrë legjitime politike. Le të qëndrojnë atje, në kënetën e tyre politike.” Më 8 tetor, Kryetari i LSDM-së, Venko Filipçe, në një tubim në Prilep, duke iu referuar Kryetarit të ZNAM-it, Maksim Dimitrievski, tha: “Dëgjova se Maksim Dimitrievski, pioni i Mickoskit, ka kërkuar debat me mua. Unë nuk debatoj me tradhtarë të idesë socialdemokrate dhe nënkontraktorë të VMRO-DPMNE-së”.

periudhës zgjedhore, për të përforcuar avantazhin e atyre që janë në pushtet.⁴⁹ Aktivitetet e fushatës të bartësve të funksioneve publike nuk janë të rregulluara, dhe funksionarët qeveritarë, duke përfshirë kryeministrin, promovuan në mënyrë aktive kandidatët lokalë në mbarë vendin gjatë gjithë fushatës.⁵⁰ Edhe pse nuk përbënin shkelje të ligjit, praktikat e tilla e zbehën vijën ndarëse midis shtetit dhe partisë, në kundërshtim me paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.⁵¹

Ligji i inkurajon garuesit të nënshkruajnë Kodin për Zgjedhje të Drejta dhe Demokratike, një instrument vetërregullues që, ndër të tjera, e ndalon presionin mbi nëpunësit shtetërorë dhe punonjësit e sektorit publik.⁵² Megjithatë, shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it theksuan se punonjësit e sektorit publik u është bërë presion nga eprorët e tyre për të mbështetur VMRO-DPMNE-në ose kryetarin aktual të komunës, e disa raportuan raste ku punonjësit e komunës u urdhëruan të merrnin pjesë në fushatë.⁵³ Për më tepër, MVZ-së së ODIHR-it iu raportuan pretendime për frikësim të votuesve dhe të kandidatëve të opozitës, si dhe raste të inspektimeve të dyshuara administrative të synuara nga autoritetet ndaj mbështetësve të opozitës.⁵⁴ Një numër i konsiderueshëm bashkëbiseduesish të MVZ-së së ODIHR-it pretenduan se partitë politike me mjete të konsiderueshme financiare u përfshinë në blerjen e votave, duke synuar veçanërisht komunitetet me ekonomiksht të cënueshme, pavarësisht përprjekjeve shumëvjeçare për ta luftuar këtë praktikë.⁵⁵

Zhvillimi i fushatës në rrjetet sociale, duke përfshirë reklamimin e paguar politik dhe fushatat e palëve të treta, nuk është i rregulluar në mënyrë të veçantë, por ligji kërkon që të gjitha reklamimet e paguara politike të paguara të shënohen në mënyrë të qartë dhe të ndahen nga përmbajtja tjetër.⁵⁶ Nuk ka asnjë autoritet mbikëqyrës me mandat për të monitoruar fushatën në rrjetet sociale, duke përfshirë dezinformatat, përmbajtjet manipuluese ose sjelljen e koordinuar joautentike.⁵⁷ Në vitin 2023, Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHMAA) hartoi një Kod vullnetar të Sjelljes në Hapësirën Online gjatë Proceseve Zgjedhore dhe Referendumeve, që e trajton reklamimin politik,

⁴⁹ Në komunat ku u ngritën shqetësime të tilla, nga 9 gushti deri më 17 tetor, u iniciuan një numër procesesh të furnizimeve publike për projekte të reja infrastrukturore. Për shembull, komuna e Butelit iniciuan ose publikoi 3 procedura të reja për furnizime publike për zhvillimin e infrastrukturës dhe miratoi 16 vendime pozitive për furnizime të hapura; Gostivari inicioi 5 ndërsa Karposhi inicioi 8 procedura për furnizime të hapura, dhe të dyja komunat miratuan vendime për 18 procedura. Tetova inicioi 2 procedura për furnizime dhe miratoi 34 vendime pozitive. Buxhetet vjetore të komunave të Gostivarit dhe Tetovës nuk janë të disponueshme publikisht.

⁵⁰ Nga 98 ngjarje të fushatës të vëzhguara nga MVZ-ja e ODIHR-it, zyrtarët qeveritarë bënë fushatë aktive në 33 prej tyre. Për shembull, Kryeministri foli në tubimet e fushatës më 29 shtator në Aerodrom, më 4 tetor në Jegunovcë, më 10 tetor në Dojran dhe Vallandovë, dhe më 13 tetor në Veles. Zëvendëskryeministri Aleksandar Nikoloski foli më 29 shtator në Prilep, më 5 tetor në Strumicë dhe më 13 tetor në Rosoman.

⁵¹ Paragrafi 5.4 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së i vitit 1990](#), kërkon “një ndarje të qartë mes shtetit dhe partive politike”.

⁵² Në të paktën dhjetë komuna dhe në Qytetin e Shkupit, kandidatët e partisë “Levica” njoftuan se do të tërhiqen nga nënshkrimi i kodit jo-detyrues.

⁵³ Pretendime për presione ndaj punonjësve komunalë nga eprorët e tyre pati në Dibër, Koçan, Kriva Pallankë, Mogillë, Novaci, Ohër, Shuto Orizare, Strugë dhe Tetovë.

⁵⁴ Pretendime për frikësim të votuesve pati në Haračinë, Manastir, Bërvenicë, Gazi Babë, Llabunishtë, Mogillë, Strugë dhe Sveti Nikole. Pretendime për presion mbi kandidatët e opozitës pati në Manastir, Kumanovë, Mogillë dhe Prilep. Pretendime për inspektime të synuara kundër mbështetësve të opozitës pati në Manastir, Llabunis

dezinformimin, retorikën diskriminuese dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Megjithatë, vetëm pesë parti politike dhe katër kandidatë të pavarur që garonin në këto zgjedhje e kishin nënshkruar atë.⁵⁸

Kandidatët dhe partitë politike u mbështetën shumë në promovimin përmes rrjeteve sociale dhe zhvilluan fushatë aktive në Facebook që nga fillimi i periudhës zyrtare të fushatës, dhe, në një masë më të vogël, në Instagram dhe TikTok.⁵⁹ Përderisa në fillim të fushatës, shumica e postimeve i paraqisnin kandidatët dhe programet me një ton neutral, duke shpërndarë përmbajtje nga ngjarjet e fushatës, toni i përdorur në rrjetet sociale u bë gjithnjë e më akuzues në fazat përfundimtare të fushatës. Gjithashtu, u vunë re disa raste të retorikës nxitëse.⁶⁰ Një numër funksionarësh të lartë qeveritarë dhe kryetarë aktualë të komunave i përdorën llogaritë e tyre zyrtare në Facebook për të bërë fushatë.⁶¹ Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it raportuan ngacmime online dhe sulme mizogjine, duke përfshirë edhe ato nga llogari të rreme. Gjithashtu, u ngritën shqetësime në lidhje me përhapjen e mundshme të narrativeve të dëmshme dhe përmbajtjeve manipuluese online gjatë periudhës zgjedhore. Pavarësisht rritjes së cenueshmërisë digjitale, nuk është krijuar asnjë mekanizëm gjithëpërfshirës institucional për të luftuar kërcënimet digjitale ndaj zgjedhjeve, duke përfshirë ndikimin e koordinuar keqdashës dhe dezinformimin.

Retorika negative shoqëroi pjesëmarrjen politike të grave, veçanërisht online, ku gratë përballeshin shpesh me fyerje verbale, kërcënime dhe përmbajtje eksplicite shqetësuese.⁶² Barazia gjinore dhe të drejtat e grave kryesisht mungonin në platformat dhe diskursin e fushatës së kandidatëve, dhe kur përmendeshin, gratë portretizoheshin kryesisht si votuese, e jo si aktore politike. Përfaqësueset e shoqërisë civile të grave potencuan se ka një regres të gjerë në të drejtat e grave dhe një rënie në progresin drejt demokracisë pjesëmarrëse. Sipas disa bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, ndikimi në rritje i lëvizjes anti-gjinore, shpesh i mbështetur nga udhëheqësit fetarë dhe i papenguar nga partitë politike, dëmton arritjet e mëparshme në politikën e barazisë gjinore.⁶³

Partitë që përfaqësonin bashkësitë më të vogla etnike bënë fushatë në mënyrë të lirshme, duke zhvilluar aktivitete informuese në gjuhët dhe zonat e tyre përkatëse. Në këto zgjedhje morën pjesë gjithsej 20 parti që përfaqësonin bashkësitë më të vogla etnike.⁶⁴ Ndërkohë që shumë nga këto parti politike tradicionalisht janë rreshtuar me partitë e mëdha përmes aleancave ose koalicioneve zgjedhore, në këto zgjedhje, disa prej tyre garuan në mënyrë të pavarur, duke argumentuar se ruajtja e bazës së tyre të

⁵⁸ Shih [Kodin e Sjelljes në Hapësirën Online gjatë Proceseve Zgjedhore dhe Referendumeve](#).

⁵⁹ MVZ-ja e ODIHR-it ndoqi aktivitetet e fushatës së 47 llogarive të partive politike, koalicioneve, kandidatëve dhe influencuesve në Facebook.

⁶⁰ Më 30 shtator, Kryetari i partisë “Levica”, Dimitar Apasiev, postoi komente përçmuese kundër një kundërshtari politik. Gjatë javës së parë të fushatës, në Facebook u postuan sulme përçmuese, eksplicite dhe mizogjine kundër Luna Stefanovskës, kandidate e VMRO-DPMNE-së për Këshillin e Qytetit të Shkupit. Më 13 tetor, koalicioni i udhëhequr nga BDI postoi një video të Kryetarit të Komunës së Tetovës, Bilall Kasami, me mbishkrimin: “shërbëtori i VMRO-së dhe Mickoskit!”

⁶¹ Për shembull, kryetarët e komunave të Berovës, Gostivarit, Kisella Vodës, Kumanovës, Ohrit dhe Tetovës bënë fushatë aktive në faqet e tyre zyrtare në Facebook, ashtu sikurse dhe Kryeministri, Ministri i Punëve të Jashtme, i Mbrojtjes, i Transportit dhe Lidhjeve dhe të tjerë.

⁶² Shih [Raportin e Kongresit të vitit 2020 mbi Luftimin e Dhunës Seksiste ndaj Grave në Politikë në Nivel Lokal dhe Rajonal](#), Rekomandimi 449, 7.c. “të prezantojnë ose rishikojnë kodet e sjelljes në kuvendet kombëtare, organet dhe institucionet qeveritare, duke ndaluar në mënyrë të qartë gjuhën seksiste dhe ngacmimin seksual, duke futur mekanizma efektivë për paraqitjen e ankesave dhe të sanksionimit, dhe të ndihmojnë qeveritë lokale dhe rajonale në zbatimin e masave në lidhje me dhunën seksiste nd

votuesve u siguron një pozicion më të fortë negociues pas zgjedhjeve. Disa parti politike që përfaqësojnë komunitetet rome dhe turke zgjodhën të garojnë të pavarura në komunat me komunitete të përqendruara, mirëpo në komuna të tjera, iu bashkuan koalicionet të udhëhequra nga partitë e mëdha. Të gjitha partitë serbe dhe vllahe iu bashkuan koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja.

Financimi i fushatës

Financimi i fushatës dhe financimi politik janë të rregulluar kryesisht me Kodin Zgjedhor, Ligjin për Financimin e Partive Politike dhe Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktin e Interesave. Shumica e rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it që kanë të bëjnë me financimin e fushatës mbeten të patrajtuara, duke përfshirë edhe ato që lidhen me raportimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në nivel të njërive zgjedhore si në raportet e përkohshme ashtu edhe në ato përfundimtare, dorëzimin elektronik të raporteve të fushatës, rregullimin e kredive bankare, reklamimin e paguar politik në rrjetet sociale, financimin nga palët e treta, kufizimet e rrepta për donacionet pas zgjedhjeve dhe sigurimin e burimeve të adekuata për organet mbikëqyrëse.

Fushatat mund të financohen nga burime publike dhe private. Në praktikë, fondet publike përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të financimit të përgjithshëm të fushatës përmes mekanizmave të ndryshëm.⁶⁵ Edhe pse nuk ka financim të drejtpërdrejtë publik, shteti, përmes KSHZ-së, i kompenson mediat e regjistruara transmetuese, të shkruara dhe ato online për reklamimin politik (shih *Mediat*). Partitë politike që marrin financim nga shteti mund t'i përdorin këto fonde edhe për qëllime të fushatës.⁶⁶

Financimi privat përfshin kredi bankare, të cilat nuk rregullohen në mënyrë gjithëpërfshirëse, dhe donacione monetare ose me natyrë tjetër, të kufizuara në 3,000 euro për individ dhe 30,000 euro për person juridik për çdo fushatë, në ekuivalent në denarë të Maqedonisë (MKD). Donacionet nga burime të huaja, shtetërore, komunale dhe anonime, si dhe nga organizatat publike, fetare dhe ato bamirëse, janë të ndaluara. Shpenzimet e fushatës janë të kufizuara në 110 denarë (afërsisht 1,8 euro) për çdo votues të regjistruar në një komunë, që zbatohet për të dy rrethet e zgjedhjeve për kryetar komune. Për qëllime raportimi, ligji nuk bën dallim midis zgjedhjeve për kryetar komune dhe atyre për këshill komunal dhe përcakton ngushtësisht se kush është i kualifikuar të jetë pjesëmarrës në zgjedhje. Për rrjedhojë, vetëm partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e pavarur ose listat e kandidatëve të pavarur janë të detyruar të dorëzojnë raporte të financimit të fushatës.⁶⁷

Nga të gjithë kandidatët kërkohet të hapin llogari të dedikuara bankare, përmes të cilave duhet të përpunohen të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës.⁶⁸ Mbikëqyrja i është besuar Entit Shtetëror të Revizionit (ESHR) dhe Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK). Çdo garues duhet të dorëzojë tre raporte të përkohshme, dy para ditës së zgjedhjeve dhe një pas saj, të cilat nuk i

⁶⁵ Për shembull, raportet e para të financimit të fushatave zbuluan se donacionet nga subjektet private u raportuan vetëm nga një garuese dhe arritën në rreth 427.000 euro, ndërsa transferimet nga llogaritë e rregullta të partive politike, të cilat financohen nga burime publike, arritën në total pothuajse 760.000 euro.

⁶⁶ Sipas Ligjit për Financimin e Partive Politike, 0,15 për qind e të ardhurave vjetore të buxhetit të shtetit është caktuar për subvencione për partitë politike, ku 70 për qind u ndahen partive parlamentare, në mënyrë proporcionale, me mandatet e tyre të deputetëve, dhe 30 për qind u ndahen në mënyrë të barabartë të gjitha partive kanë marrë të paktën 1 për qind të votave në zgjedhjet e fundit parlamentare ose lokale. Në vitin 2024, financimi shtetëror për partitë politike arriti në afërsisht 7,5 milionë euro. Ligji nuk i kufizon transferimet nga llogaritë e rregullta të partive në llogaritë e fushatës.

⁶⁷ Ndërkohë që 309 kandidatë për kryetar komune dhe 577 lista për këshilltarë garuan në këto zgjedhje, KSHZ-ja [publikoi](#) se ka 153 garues të regjistruar.

⁶⁸ Nga gjithsej 886 kandidatë për kryetar komune dhe lista këshillash të regjistruara, autoritetet e informuan MVZ-në e ODIHR-it se vetëm 167 llogari bankare ishin hapur për qëllime fushate.

nënshtrohen revizionit.⁶⁹ Të gjitha raportet dorëzohen në ESHR, KSHPK dhe KSHZ, të cilat i publikojnë ato në faqet e tyre të internetit. Brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultateve zyrtare të zgjedhjeve, pjesëmarrësit e fushatës duhet të dorëzojnë raporte përfundimtare tek ESHR-ja, e cila më pas ka 60 ditë kohë për t'i bërë revizion. Shablloni i raportimit, i ofruar nga Ministria e Financave para zgjedhjeve të vitit 2024, nuk kërkon ndarje të shpenzimeve sipas komunave, gjë që e pengon verifikimin e respektimit të kufijve të shpenzimeve, në kundërshtim me ligjin.⁷⁰ Për më tepër, raportet e përkohshme i përfshijnë vetëm donacionet, dhe nuk i përfshijnë kreditë, transferimet nga llogaritë e rregullta të partive dhe shpenzimet, duke e zvogëluar kështu transparencën dhe duke mos i përmbushur praktikatat e mira ndërkombëtare.⁷¹

Kodi Zgjedhor parashikon gjoba deri në 9.000 euro për shkelje të rregullave të financimit të fushatës, duke përfshirë tejkalimin e kufirit për donacione ose shpenzime ose mosdorëzimin e raportit financiar, por nuk specifikon se cili institucion duhet të iniciojë procedurat në rast shkeljesh. Në vend të kësaj, KSHZ-ja, KSHPK-ja dhe ESHR-ja duhet të nënshkruajnë një Memorandum Mirëkuptimi (MM) për të koordinuar zbatimin e dispozitave të financimit të fushatës, duke përfshirë ndarjen e informacionit dhe ndjekjen e parregullsive të konstatuara.⁷²

Para fillimit të fushatës, ESHR-ja zhvilloi dy sesione trajnimi për personelin financiar të garuesve për plotësimin e raporteve financiare. Trajnimi i përfshiu kërkesat ligjore lidhur me financimin e fushatës dhe përfshiu shabllone shembull të raporteve. Megjithatë, disa çështje praktike, duke përfshirë boshllëqet në shabllonin e raportimit dhe përkufizimet e paqarta se kush konsiderohet pjesëmarrës, mbetën të pazgjidhura, gjë që shkaktoi interpretime të paqëndrueshme dhe, nganjëherë, tepër të ngushta si nga pjesëmarrësve ashtu edhe nga institucionet mbikëqyrëse. Në kombinim me boshllëqet sistemore dhe kapacitetin e kufizuar institucional, këto mangësi e penguan mbikëqyrjen efektive të financimit të fushatës.⁷³

Mediat

Ambienti mediatik është i larmishëm, por i fragmentuar përgjatë vijave politike dhe etnike, dhe funksionon brenda një tregu të kufizuar reklamash. Televizioni (TV) mbetet burimi kryesor i informimit

⁶⁹ 167 raportet e para të përkohshme duhej të dorëzoheshin më 9 tetor, deri në orën 24:00, ndërsa grupi i dytë i raporteve duhej të dorëzohej një ditë para ditës së zgjedhjeve. Një raport shtesë duhet të dorëzohet një ditë para balotazheve të mundshme për kryetar komune. Sipas KSHPK-së, pothuajse dy të tretat e pjesëmarrësve nuk e dorëzuan fare raportin e tyre të parë të përkohshëm, ndërsa përmbajtja dhe koha e publikimit të raporteve të dorëzuara ndryshonin. Sipas vulave kohore të raporteve të publikuara, 45 nga 56 raportet e publikuara në faqen e internetit të KSHZ-së u dorëzuan brenda afatit kohor; 57 nga 58 raportet e publikuara në faqen e internetit të KSHPK-së; dhe 37 nga 56 raportet e publikuara në faqen e internetit të ESHR-së u dorëzuan brenda afatit kohor. Nga këto raporte, 15 përmbanin informacion vetëm për donacionet, 32 raportuan zero donacione ose ishin lënë të zbrazëta, ndërsa 19 përmbanin edhe shpenzime. Vetëm tre raporte përfshinin informacione që nuk kërkoreshin nga udhëzimet për raportim, duke përfshirë fondet e transferuara nga partitë politike ose donacionet në natyrë. Raportet e para u publikuan një ditë pas dorëzimit nga ESHR-ja dhe KSHPK-ja, ndërsa KSHZ-ja i publikoi ato katër ditë më vonë. Raportet e dyta u publikuan në ditën e zgjedhjeve vetëm nga KSHPK-ja. Raporti i tretë i përkohshëm duhet të dorëzohet një ditë pas mbylljes së llogarisë bankare të dedikuar për fushatën dhe mbulon periudhën midis përfundimit të fushatës dhe mbylljes së llogarisë.

⁷⁰ Kufiri i shpenzimeve në këto zgjedhje ndryshon nga rreth 3.400 euro në Llozovë deri në rreth 168.000 euro në Kumanovë. Për më tepër, për zgjedhjet e Këshillit të Qytetit të Shkupit dhe për kryetarë të komunave, kufiri i shpenzimeve është rreth 848,000 euro.

⁷¹ Paragrafi 261 i [Udhëzimeve të ODIHR-it të vitit 2020 për Rregulloren për Partitë Politike](#) thekson se “është praktikë e mirë të kërkohej [...] raporte që u japin organeve mbikëqyrë

politik, mirëpo portalet e lajmeve online dhe platformat e rrjeteve sociale kanë ndikim gjithnjë e më të madh. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it shprehën shqetësime në lidhje me mungesën e mediave lokale në disa rajone. Ata gjithashtu i potencuan kushtet e pafavorshme të punës dhe burimet e kufizuara njerëzore në sektorin e mediave, që kanë ndikuar si në kapacitetet gazetareske ashtu edhe në ato teknike. Edhe pse korniza ligjore parashikon mbrojtjen e gazetarëve, frikësimi, veçanërisht jashtë kryeqytetit, sulmet online, duke përfshirë ato ndaj grave, dhe incidentet e izoluara të dhunës fizike ndaj gazetarëve mbeten shqetësim.⁷⁴

Kushtetuta e garanton lirinë e shprehjes dhe të medias. Ndryshimet e vitit 2025 në Ligjin për Mediat futën një përkufizim të mediave online dhe një regjistër vullnetar për mediat online, me qëllim të rritjes së transparencës. Kodi Zgjedhor kërkon që mediat t'i mbulojnë zgjedhjet në mënyrë të drejtë, të balancuar, dhe të paanshme. Pavarësisht rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it, lajmet e transmetuesit publik, Radiotelevizionit të Maqedonisë (RTM), gjatë fushatës vazhdojnë t'u nënshtrohen rregulloreve të rrepta. Edhe pse këto rregullore synojnë të sigurojnë qasje të barabartë, ato e kufizojnë pavarësinë redaktuese të transmetuesit.⁷⁵ ASHMAA-ja e mbikëqyri respektimin e kërkesave ligjore që kanë të bëjnë me mbulimin e zgjedhjeve nga ana e mediave, nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në përfundim të votimit, duke publikuar shtatë raporte javore para fillimit zyrtar të fushatës dhe raporte ditore gjatë saj.⁷⁶

Kandidatët për kryetarë komune kanë të drejtë për mbulim të barabartë nga të gjithë transmetuesit, ndërsa dorëzuesit e listave për këshilltarë kanë të drejtë për mbulim të barabartë në mediat lokale. Për shkak të numrit të madh të garuesve dhe kapacitetit të kufizuar të mediave, vendimi se cilët kandidatë do të ftoheshin në debatet e shumta në mediat private mbeti nën diskrecionin e redaksive dhe disa kandidatë refuzuan të marrin pjesë. Disa media lokale organizuan debate dhe intervista me kandidatët në komunat e tyre përkatëse. Për shkak të numrit të kufizuar të mediave të tilla, ndikimi nuk ishte i rëndësishëm. Në mediat kombëtare, përveç partive kryesore dhe kandidatëve të tyre, disa parti më të vogla dhe disa kandidatë të pavarur kishin mundësi t'i prezantonin platformat e tyre politike. Tre nga pesë transmetuesit privatë kombëtarë tokësor e informuan MVZ-në e ODIHR-it se disa parti parlamentare iu shmangën pjesëmarrjes në programet e tyre. Një program ditor lajmesh dhe një program javor në kohën me shikueshmëri më të madhe në transmetuesit kombëtarë u plotësuan me titra ose në gjuhën maqedonase të shenjave, siç kërkohet me ligj.

Reklamat e paguara politike në media gjatë periudhës së fushatës financohen drejtpërdrejt dhe ekskluzivisht nga buxheti i shtetit. Formula e shpërndarjes i favorizon ndjeshëm partitë kryesore parlamentare, ndërkohë që u mohon mundësi domethënëse partive më të vogla dhe kandidatëve të pavarur, dhe nuk ofron as fonde e as kohë transmetimi për partitë më të vogla me grup

⁷⁴ Më 2 tetor, Shoqata e Gazetarëve (SHGM) [njoftoi](#) se e kishte përjashtuar Zoran Bozhinovskin pas një serie fyerjesh me bazë gjinore kundër grave gazetare përmes postimeve në rrjetet sociale. Në vitin 2025, SHGM-ja raportoi dy raste në MPB, në lidhje me një sulm fizik ndaj një ekipi televiziv në Shkup dhe zjarrvënien e automobilit të një gazetari në Ohër.

⁷⁵ Gjatë periudhës zyrtare të fushatës, RTM-ja është e obliguar t'i kushtojë 30 për qind të lajmeve ngjarjeve të përgjithshme, 30 për qind partive shumicë në parlament, 30 për qind opozitës parlamentare dhe 10 për qind partive joparlamentare dhe kandidatëve të pavarur.

⁷⁶ Më 7 tetor, ASHMAA-ja publikoi të dhënat e monitorimit për periudhën midis shpalljes së zgjedhjeve dhe fillimit të fushatës, duke vënë re njëfarë mosbalancimi në mbulimin mediatik nga TV Alfa dhe Alsat-M, por pa shkelje ligjore. Alsat-M parashittoi kundërshtim, duke i kundërshtuar këto konkluzione. Gjithashtu, më 8 tetor, ASHMAA-ja nisi një procedurë kundërvajtjeje kundër televizionit Gurra të Kërçovës për tejkalim të kufirit të reklamave të paguara politike.

parlamentar.⁷⁷ Levica parashtroi disa kërkesa duke i kundërshtuar këto udhëzime (shih *Zgjidhja e kontesteve zgjedhore*). Mediat që dëshirojnë të ofrojnë kohë transmetimi ose hapësirë të paguar për reklama të fushatës duhet të regjistrohen në KSHZ dhe t'i publikojnë listat e tyre të çmimeve.⁷⁸ Megjithëse kompensimi për transmetuesit bazohet në monitorimin e ASHMAA-së, kompensimi për mediat online nuk është transparent dhe nuk ka mbikëqyrje të tyre. Shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it pretenduan se kjo dispozitë shfrytëzohet nga partitë politike për të kanalizuar fondet përmes mediave besnike ndaj tyre.

Sipas monitorimit të mediave nga MVZ-ja e ODIHR-it, mbulimi në lidhje me zgjedhjet në mediat transmetuese gjatë periudhës së fushatës, në përgjithësi, ishte i balancuar.⁷⁹ Partitë kryesore dhe koalicionet shpesh u prezantuan nga kryetarët e partive të tyre. Debatet televizive u organizuan nga kanale private, pothuajse ekskluzivisht për kandidatët për kryetarë komune.. Partitë joparlamentare dhe kandidatët e pavarur kishin afërsisht dy dhe pesë për qind të mbulimit në lajme në transmetuesit publikë, përkatësisht, dhe deri në dy dhe tre për qind në kanalet private. Mbulimi në periudhën para fushatës në televizionet private dhe mediat online e pasqyroi polarizimin politik, kurse raportimi negativ mbi partitë më të mëdha buronte kryesisht nga retorika e kryetarëve të partive.

Zgjidhja e kontesteve zgjedhore

Kundërshtimet që lidhen me zgjedhjet mund të parashtrohen në KSHZ, KZK-të, gjykatat themelore, ose në KSHPK, varësisht nga çështja. Rregullimi i zgjidhjes së kontesteve zgjedhore përmban paqartësi dhe boshllëqe, duke përfshirë edhe në lidhje me afatet kontradiktore, kompetencat e paqarta për zgjidhjen e kontesteve dhe kompetencat e komisioneve zgjedhore të nivelit më të ulët.⁸⁰ Baza ligjore që u mundëson votuesve të parashtrojnë kundërshtime mbetet e kufizuar, që është në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare.⁸¹ Vëzhguesit qytetarë mund të parashtrojnë kundërshtime në lidhje me financimin e fushatës, ndërsa për sa i përket parregullsive të mundshme të vërejtura gjatë procesit

⁷⁷ Kodi Zgjedhor përcakton që 8 minuta nga çdo bllok reklamash me pagesë prej 9.5 minutash dhe 90 për qind e fondeve të ndara për fushatën në media duhet të ndahen në mënyrë të barabartë midis dy partive më të mëdha në pushtet dhe dy partive më të mëdha të opozitës parlamentare, 1 minutë dhe 7 për qind e fondeve u ndahen partive parlamentare që nuk kanë numër të mjaftueshëm deputetësh për të formuar grup parlamentar, ndërsa 30 sekonda dhe 3 për qind e fondeve duhet të ndahen midis partive joparlamentare dhe kandidatëve të pavarur. Më 16 shtator, KSHZ-ja, ASHMAA-ja, KSHPK-ja dhe ESHR-ja i dorëzuan një letër të përbashkët Kryetarit të Parlamentit, duke kërkuar të veprojnë për rregullimin adekuat të ndarjes së kohës dhe hapësirës së transmetimit me pagesë dhe shpërndarjes së fondeve për fushatën në media. ZNAM theksoi se nëpërmjet një marrëveshjeje dypalëshe atyre iu dha një përqindje e vogël e fondeve të VMRO-DPMNE-së për reklama në media.

⁷⁸ Për këto zgjedhje, në KSHZ u regjistruan 33 stacione televizive, 42 radio-stacione, 8 gazeta të përditshme dhe 246 media online.

⁷⁹ Me përjashtim të *TV Alfa*, i cili i kushtoi pothuajse 40 për qind të mbulimit të tij politik VMRO-DPMNE-së me ton pozitiv dhe rreth 45 për qind të mbulimit të tij të LSDM-së me ton negativ, duke përfshirë komente kritike nga gazetarët. Më 15 shtator, MVZ-ja e ODIHR-it filloi monitorimin mediatik të transmetuesve publikë *RTM 1* dhe *RTM 2* (në gjuhën shqipe), transmetuesve privatë *Alfa*, *Alsat-M* (në gjuhën shqipe), *Kanal 5*, *Sitel* dhe *Telma*, si dhe të artikujve që kanë të bëjnë me zgjedhjet të portaleve të lajmeve online *kurir.mk*, *plusinfo.mk*, dhe *slobodenpecat.mk*, së bashku me *tetotavot.com* dhe *lajmpress.org* (në gjuhën shqipe).

⁸⁰ Procedurat dhe aplikuesit në rastet që kanë të bëjnë me anulimin dhe përsëritjen e votimit nuk përcaktohen në mënyrë të plotë në nenin 151 të Kodit Zgjedhor, i cili gjithashtu përcakton afate që ndryshojnë nga ato të nenit 148, pavarësisht përputhjes së pjesshme midis tyre. Vëzhguesit afatgjatë të MVZ-së së ODIHR-it raportuan se shumë KZK kishin interpretime të ndryshme të kompetencave të tyre për të vendosur mbi lloje të ndryshme të kundërshtimeve, shpesh duke u mbështetur vetëm në këshillat e KSHZ-së, në vend që të shqyrtonin dhe të vendosnin në mënyrë të pavarur për rastet brenda juridiksionit të tyre.

zgjedhor, duke përfshirë edhe në ditën e zgjedhjeve, ata vetëm mund të kërkojnë që vërejtjet e tyre mbi parregullsitë e pretenduara të regjistrohen në Ditarët për evidencën e ngjarjeve të KZ-ve.

Gjykatat themelore dhe KSHZ-ja trajtojnë lloje të ndryshme të kundërshtimeve që lidhen me fushatën. KSHZ-ja gjithashtu i shqyrton kundërshtimet e garuesve në lidhje me votimin, nxjerrjen e rezultateve dhe rezultatet e zgjedhjeve. Ajo mund të fillojë procedurat për parregullsi zgjedhore sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) dhe t'i përcjellë veprat e dyshuara penale në prokurori. KZK-të i shqyrtojnë kundërshtimet në lidhje me shkeljet e të drejtave të votës në ditën e zgjedhjeve, ndërsa KSHPK-ja shqyrton ato që lidhen me financimin e fushatës dhe keqpërdorimin e burimeve administrative. Vendimet e KSHZ-së, KZK-ve dhe KSHPK-së mund të apelojnë në Gjykatën Administrative, ndërsa gjykatat e apelit i shqyrtojnë ankesat ndaj vendimeve të gjykatave themelore që lidhen me zgjedhjet. Afatet për dorëzimin e kundërshtimeve variojnë nga 12 orë deri në 2 ditë, me ç'rast lejohen 1 deri në 3 ditë për shumicën e shqyrtimeve.⁸² Disa nga këto afate janë tepër të shkurtra, duke dëmtuar potencialisht cilësinë e vendimeve.⁸³

Gjykata Kushtetuese e shqyrton kushtetutshmërinë e akteve ligjore apo vendimeve që lidhen me zgjedhjet, pa procedurë të përsheptuar. Megjithatë, pas shpalljes së zgjedhjeve lokale, Gjykata shqyrtoi disa iniciativa në mënyrë të shpejtë dhe brenda disa ditësh, duke përfshirë kontestimet për Rregulloren e KSHZ-së që rregullon mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për kandidatët e pavarur, Udhëzimet e KSHZ-së për procedurat e dorëzimit dhe regjistrimit të listave të kandidatëve, dhe vendimin e qeverisë për numrin e këshilltarëve për çdo komunë (shih *Të drejtat e kandidatëve dhe regjistrimi i tyre dhe i kandidatëve dhe Sistemi zgjedhor dhe korniza ligjore*, përkatësisht). Gjykata i hodhi poshtë të gjitha iniciativat.

Gjatë fushatës, në Gjykatën Kushtetuese u dorëzuan dy iniciativa të tjera: një nga "Levica" më 29 shtator, që kontestonte Udhëzimet e ASHMAA-së për reklamimin e paguar politik, dhe një tjetër nga Demokratët më 3 tetor, që kontestonte dispozitat e Kodit Zgjedhor në lidhje me formulën e shpërndarjes.⁸⁴ Gjykata mbajti një seancë më 15 tetor, dy ditë para përfundimit të fushatës, kur e shqyrtoi dhe e refuzoi iniciativën e partisë "Levica".⁸⁵ Edhe pse Gjykata Kushtetuese nuk është e detyruar të vendosë me afate të përsheptuara, praktika e saj për të shqyrtuar me shpejtësi çështjet që lidhen me zgjedhjet krijoi pritshmërinë tek shumë palë të interesuara se Gjykata do të vazhdonte me këtë qasje. Praktikën e tillë kanë potencialin të ndikojnë ndjeshëm në kornizën ligjore, ndërkohë që procesi zgjedhor është në zhvillim e sipër.

KSHZ-ja shqyrtoi 67 kundërshtime që lidheshin me shkelje të të drejtave të votuesve individualë dhe kërkesa për votim në shtëpi, duke i pranuar 25 dhe duke i refuzuar 42 të tjerat. Në përputhje me ligjin, KSHZ-ja mirëmbante një sistem elektronik për parashtrimin dhe ndjekjen e kundërshtimeve, por nuk e përditësonte atë vazhdimisht. Që nga shpallja e zgjedhjeve, KSHPK-ja mori rreth 25 raportime, shumica prej të cilave pretendonin keqpërdorim të burimeve shtetërore. Këto raportime nuk u trajtuan si

⁸² Kundërshtimet e votuesve në ditën e zgjedhjeve duhet të parashtrihen brenda 12 orëve dhe të shqyrtohen brenda 2 orëve.

⁸³ Seksioni h li.3.3(95)i [Raportit Shpjegues të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore](#) të Komisionit të Venedikut thotë se afatet kohore duhet [...] të zgjasin aq sa për të garantuar ushtrimin e së drejtës për ankesë, si dhe marrjen e një vendimi të peshuar mirë. Një afat kohor prej tri deri në pesë ditë në instancën e parë (duke përfshirë parashtrimin e ankesës dhe marrjen e vendimit) duket se është i arsyeshëm".

⁸⁴ Përveç kësaj, "Levica" parashtrroi disa padi në Gjykatën Themelore në Shkup, me ç'rast të gjitha u hodhën poshtë, si dhe një kundërshtim në Komisionin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të njëjtën çështje.

⁸⁵ Iniciativa e Demokratëve nuk ishte në rendin e ditës së kësaj seance të Gjykatës. Gjykata e informoi MVZ-në e ODIHR-it se kishte pranuar edhe dy iniciativa të tjera, një nga "Levica", e cila i kontestonte dispozitat e Kodit Zgjedhor mbi formulën e shpërndarjes, dhe një tjetër, nga Kongresi Botëror Maqedonas, e cila kontestonte pjesë të K

kundërshtime dhe për këtë arsye nuk u shqyrtuan në mënyrë të përshpejtuar, dhe nuk u siguruan të drejtat procedurale të palëve në rast, gjë që e kufizoi qasjen në mjet efektiv ligjor.⁸⁶

Gjykata Administrative pranoi dhe shqyrtoi katër kundërshtime para ditës së zgjedhjeve, në lidhje me regjistrimin e kandidatëve. Ajo e hodhi poshtë njërin si të vonuar dhe i miratoi vendimet e KSHZ-së dhe të KZK-ve në tre të tjerat. Gjykata gjithashtu e hodhi poshtë si të pabazuara një padi të parashtruar nga “Levica”, e cila kërkonte anulimin e Udhëzimeve të ASHMAA-së për reklamimin e paguar politik.⁸⁷ Ashtu siç kërkohet me ligj, Gjykata Administrative i publikoi vendimet e saj menjëherë.

Ndërkohë që kontestet në përgjithësi u trajtuan në mënyrë efikase, në përputhje me procedurat dhe brenda afateve të përcaktuara, shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it shprehën shqetësime në lidhje me paanshmërinë dhe pavarësinë e organeve gjyqësore, veçanërisht për sa i përket kontesteve të mundshme mbi rezultatet e zgjedhjeve.⁸⁸

Vëzhgim i zgjedhjeve

Kodi Zgjedhor parashikon si vëzhgimin qytetar ashtu edhe atë ndërkombëtar të zgjedhjeve. Përfaqësuesit e akredituar të shoqatave qytetare të regjistruara të paktën një vit para ditës së zgjedhjeve, statutet e të cilave parashikojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, organizatat ndërkombëtare dhe përfaqësuesit e vendeve të huaja, mund t’i vëzhgojnë të gjitha aspektet e procesit zgjedhor. Aplikimet për akreditimin e vëzhguesve duhet të dorëzohen në KSHZ jo më vonë se dhjetë ditë para ditës së zgjedhjeve. Garuesit në zgjedhje mund të caktojnë përfaqësues të autorizuar për të ndjekur procesin zgjedhor në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore në komunat ku ata garojnë, duke aplikuar në KZK-në përkatëse deri tre ditë para ditës së zgjedhjeve. Përfaqësuesit e mediave kishin të drejtë të ishin të pranishëm në të gjitha fazat e procesit zgjedhor, përveç numërimit të votave.

Në një proces gjithëpërfshirës, KSHZ-ja akreditoi 807 vëzhgues qytetarë nga 20 organizata dhe 644 vëzhgues ndërkombëtarë nga 21 organizata. KSHZ-ja zhvilloi gjithashtu një trajnim për vëzhguesit e akredituar dhe një punëtor për mediat. Aktivitetet e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat vëzhguese qytetare ishin minimale për shkak të mungesës së fondeve, gjë që i pamundësoi ato të shpërndajnë një numër të konsiderueshëm vëzhguesish afatgjatë dhe afatshkurtër.⁸⁹ Në vend të kësaj, ata u përqendruan në aktivitete të tilla si monitorimi i mediave dhe rrjeteve sociale, malinje në ndikimi i huaj i mundshëm keqdashës dhe fushatat e dezinformimit, keqpërdorimi i burimeve shtetërore, marrëdhëniet ndërmjet bashkësive dhe qasshmëria e procesit zgjedhor.⁹⁰

Dita e zgjedhjeve

Dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht e qetë dhe e rregullt. Sipas të dhënave paraprake të KSHZ-së, pjesëmarrja në votime arriti në 48,46%. KSHZ-ja i publikoi të dhënat e pjesëmarrjes në votime sipas

⁸⁶ Sipas ligjit, KSHPK-ja duhet t’i shqyrtojë dhe të vendosë për kundërshtimet që lidhen me shkeljen e rregullave të financimit të fushatës dhe keqpërdorimin e burimeve administrative brenda pesë ditëve. KSHPK-ja shqyrtoi 12 raportime në seancën publike të mbajtur më 13 tetor.

⁸⁷ Më 13 tetor, “Levica” parashitroi një ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Lartë Administrative.

⁸⁸ Sipas [Raportit të Komisionit Evropian për Sundimin e Ligjit për vitin 2024](#), vetëm 25 për qind e publikut të gjerë dhe 20 për qind e kompanive i konsiderojnë gjykatat mjaft ose shumë të pavarura. [Raporti i Zgjerimit i Komisionit Evropian për vitin 2024](#) thekson se “...pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit duhet të përmirësohen. Ndërhyrjet e jashtme ose politike mbetet një shqetësim serioz. Niveli i perceptuar i besimit në gjyqësor mbetet shumë i ulët.”

⁸⁹ Nga organizatat kryesore të vëzhguesve qytetarë që ishin të përfshira më parë në vëzhgimin e zgjedhjeve, CIVIL – Qendra për Liri shpërndau 6 vëzhgues afatgjatë dhe 60 vëzhgues afatshkurtër, nd

komunave çdo dy orë gjatë gjithë ditës, duke filluar nga ora 09:00, dhe filloi t'i publikojë rezultatet paraprake të zgjedhjeve deri në nivel të vendvotimeve rreth orës 21:00, duke kontribuar kështu për transparencën. Në katër komuna, zgjedhjet për kryetar komune do të duhet të përsëriten pasi në zgjedhje morën pjesë më pak se një e treta e votuesve të regjistruar. Në një numër komunash, kishte raste të fletëvotimeve dhe posterëve informues të shtypur gabimisht, duke përfshirë edhe për zgjedhjet e Këshillit të Qytetit të Shkupit. Gratë ishin të përfaqësuara mirë në KZ-të në vendvotimet e vëzhguara nga MNVZ-ja; ato përbënin 49 për qind të anëtarëve të KZ-ve dhe ishin kryetare në 66 për qind të KZ-ve të vëzhguara.

Për fat të keq, 54 për qind e vendvotimeve të vëzhguara nuk ofruan mundësi për hyrje të pavarur për votuesit me aftësi të kufizuara fizike, ndërsa në 27 për qind të vendvotimeve, organizimi i brendshëm i hapësirës nuk ishte i përshtatshëm për këta votues. Pozitivisht, 95 për qind e vendvotimeve të vëzhguara ishin të pajisura me shabllone të fletëvotimeve me prekje në alfabetin e Brejtit për përdorim nga votuesit me shikim të dëmtuar.

Shumica e vendvotimeve u hapën në kohë ose me vonesa të vogla. Hapja u vlerësua pozitivisht në 105 nga 109 vëzhgimet, duke nxjerrë në pah zbatimin përgjithësisht të njëtrajtshëm të procedurave. Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan disa raste të gabimeve procedurale, duke përfshirë 14 raste ku kutitë e votimit nuk u treguan se ishin të zbrazëta përpara se të mbylleshin, dhe 27 raste ku protokollin e hapjes nuk u plotësua përpara se të hapesh vendvotimi. Probleme me aktivizimin e Pajisjeve Biometrike për Identifikimin e Votuesve (PBIV) u vunë re në një të tretën e hapjeve të vëzhguara, dhe afërsisht e njëjta përqindje e vendvotimeve u hapën kryesisht me vonesa të vogla.

Vëzhguesit e MVZ-së e vlerësuan votimin pozitivisht në 98 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, duke e përshkruar procesin si të qetë, të efikas dhe të organizuar mirë. Përfaqësuesit e autorizuar të garuesve ishin të pranishëm në 84 për qind të vendvotimeve të vëzhguara dhe morën pjesë në 20 nga 22 rastet e ndërhyrjes të vëzhguara nga MNVZ-ja. Vëzhguesit qytetarë ishin të pranishëm vetëm në 6 për qind të vendvotimeve të vëzhguara. Prania e personave të paautorizuar u vu re në tetë vendvotime. Procedurat e identifikimit të votuesve u respektuan pothuajse në mënyrë universale. Megjithatë, vëzhguesit e MNVZ-së raportuan se në 27 përqind të vendvotimeve të vëzhguara, jo të gjithë votuesit mund të identifikoheshin nga PBIV-të në bazë të gjurmëve të gishtërinjve, dhe në 2 për qind kishte probleme teknike me pajisjet. Në 8 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, një ose më shumë votues u kthyen prapë, në shumicën e rasteve pasi që emrat e tyre nuk mund të gjendeshin në listën e votuesve ose për shkak se nuk mund të tregonin një dokument të vlefshëm të identifikimit.

Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan disa probleme në lidhje me fshehtësinë e votës. Në 7 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, jo të gjithë votuesit i shënuan fletët e tyre të votimit në fshehtësi. Në 4 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, organizimi i hapësirës nuk ishte i përshtatshëm për zhvillimin e votimit dhe nuk siguronte fshehtësinë e votës. Mbipopullim u vërejt në 4 për qind të vëzhgimeve. Në 38 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, votuesit nuk u udhëzuan në mënyrë konsekuente mbi procedurat e votimit dhe se si t'i shënonin siç duhet fletëvotimet e tyre.

Mangësitë serioze procedurale të vërejtura nga vëzhguesit e MNVZ-së përfshinin votimin në grup, që u raportua në 3 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, dhe përpjekjet për të ndikuar te votuesit se për kë të votojnë (1 për qind). Në 2 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, kutitë e votimit nuk ishin mbyllur siç duhet. Vëzhguesit e MNVZ-së gjithashtu raportuan se në 3 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, u pa se njerëz të tjerë përveç anëtarëve të Kz-ve mbanin evidencë të votuesve që kishin votuar, që mund të jetë tregues për presion të mundshëm mbi votuesit dhe për përpjekje për të ndikuar në mënyrë të padrejtë në zgjedhjen e tyre. Materiale ose aktivitete të fushatës u raportuan jashtë 4 për qind të vendvotimeve të vëzhguara.

Shumica dërmuese e 104 numërimeve të votave të vëzhguara nga MNVZ-ja u vlerësuan pozitivisht, megjithëse disa vëzhgues e përshkruan procesin si të çorganizuar dhe kaotik. Megjithatë, mosrespektimi

i shpeshtë i procedurave të përcaktuara, si dhe gabimet ose lëshimet procedurale bënë një procesi të vlerësohet negativisht në 13 vëzhgime. Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan se KZ-të shpesh nuk i kryenin procedurat e parapara të harmonizimit të rezultateve, si p.sh. numërimin dhe regjistrimin e numrit të fletëvotimeve të papërdorura në protokollin e rezultateve (nga 30 raste secila) ose përcaktimin e numrit të votuesve që votuan duke i numëruar nënshkrimet në listën e votuesve (24 raste). U vërejt se vetëm 38 KZ i kishin kryer të gjitha hapat e përcaktuar para hapjes së kutive të votimit. Numërimi i fletëve të votimit u krye në mënyrë transparente në pothuajse të gjitha rastet, por në më shumë se gjysmën e numërimeve të vëzhguara, hapat e ndryshëm nuk u ndoqën sipas rendit të përcaktuar. Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan gjithashtu shkelje procedurale, si p.sh. protokolle të rezultateve të nënshkruara paraprakisht nga anëtarët e KZ-ve (10 raste) ose pjesëmarrje në numërim të personave që nuk ishin anëtarë të KZ-së (18 raste). Në 3 numërime të vëzhguara, rezultatet nuk u harmonizuan, dhe në 31 raste, KZ-të hasën vështirësi në plotësimin e protokolleve të rezultateve. Mangësitë e tjera procedurale përfshinin mos-ngjitjen e kopjeve të protokolleve të rezultateve në vendvotime nga KZ-të (43 raste), gjë që ndikoi negativisht në transparencën, dhe mos-dërgimi në mënyrë elektronike i rezultateve paraprake te KSHZ-ja (23 raste).

Vëzhguesit e MNVZ-së e vlerësuan pozitivisht nxjerrjen e rezultateve në të gjitha rastet, përveç në 6 prej 89 raporteve të dorëzuara nga 76 KZK, duke e përshkruar procesin si transparent në shumicën e rasteve, megjithëse ndonjëherë të çorganizuar. Ata raportuan se hapësirat e KZK-ve nuk ishin gjithmonë të përshtatshme për pranimin e materialeve zgjedhore (15 raste) dhe vunë re raste të mbipopullimit (10 raste) dhe të tensioneve brenda ose përreth hapësirave të KZK-ve (4 raste). Pothuajse tre të katërtat e hapësirave të KZK-ve nuk ofruan mundësi për hyrje të pavarur për votuesit me aftësi të kufizuara fizike. Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan gjithashtu disa mangësi procedurale, duke përfshirë KZK-të që nuk bënë në mënyrë konsekuente ndryshime në protokollin e rezultateve të KZ-ve në bazë të materialit të inspektuar zgjedhor, siç kërkohet me ligj (26 raporte), dhe raste të KZ-ve që i korrigjonin protokollin në KZK (25 raporte). Më shumë se gjysma e protokolleve të dorëzuara nga KZ-të përmbanin mospërputhje. Gjashtëdhjetë raporte vëzhgimi vunë në dukje praninë e përfaqësuesve të autorizuar të garuesve në KZK, të cilët mund të ndiqnin procesin pa asnjë kufizim. Vëzhguesit e MNVZ-së nuk raportuan asnjë rast ndërhyrjeje në procesin e nxjerrjes së rezultateve.

KSHZ-ja raportoi se nuk kishte marrë asnjë kundërshtim gjatë ditës së zgjedhjeve. Në të njëjtën kohë, deri në përfundim të votimit, KSHZ-ja publikoi informacion për rreth 286 kundërshtime të parashtruara nga votuesit në lidhje me të drejtën e tyre për të votuar, të cilat ishin shqyrtuar nga KZK-të. Sipas KSHZ-së, 156 nga këto kundërshtime u pranuan, 100 u refuzuan, ndërsa rreth 30 mbeten nën shqyrtim. Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan se u parashtruan dy kundërshtime në lidhje me parregullsi gjatë proceseve të votimit dhe nxjerrjes së rezultateve. Prokuroria Publike e Shtetit nuk raportoi incidente të mëdha, por vuri në dukje disa raste të izoluara të pretendimeve për blerje të votave, ndikimit të padrejtë mbi votuesit dhe një rast të shkeljes së fshehtësisë së votës, me ç'rast të gjitha janë nën hetim. Policia raportoi se 11 persona u ndaluan dhe u arrestuan ditën e zgjedhjeve me dyshime ose akuza për blerje votash, shkatërrim të materialeve zgjedhore dhe për fotografimin e dokumenteve të identifikimit të votuesve.

***Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar.
Janë në dispozicion përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.***

INFORMATA PËR MISIONIN DHE MIRËNJOHJE

Shkup, 20 tetor 2025 – Kjo Deklaratë për gjetjet dhe përfundimet paraprake është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) të OSBE-së, Parlamentit Evropian (PE) dhe Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës (Kongresi). Vlerësimi u bë për të përcaktuar nëse zgjedhjet u mbajtën në përputhje me angazhimet e OSBE-së, standardet e Këshillit të Evropës, dhe obligimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin shtetëror. Secila nga institucionet e përfshira në këtë Mision Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve e kanë miratuar Deklaratën e parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve të vitit 2005.

Matteo Mecacci është shef i MVZ-së së ODIHR-it, që filloi me punë më 5 shtator. Delegacioni i Kongresit u udhëhoq Gobnait Ní Mhuimhneacháin. Delegacionin e PE-së e udhëhoqi Marta Temido.

Kjo Deklaratë e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake dorëzohet para përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve do të varet, pjesërisht, nga zhvillimi i fazave të mbetura të procesit zgjedhor, duke përfshirë numërimin, nxjerrjen e rezultateve, dhe shpalljen e rezultateve, shqyrtimin e ankesave ose kundërshtimeve pas zgjedhjeve, dhe zgjedhjet e rrethit të dytë. ODIHR-i do të publikojë një raport gjithëpërfshirës përfundimtar, duke përfshirë rekomandime për përmirësime eventuale, disa muaj pas përfundimit të procesit zgjedhor. Delegacioni i PE-së do ta informojë Delegacionin e PE-së për Marrëdhënie me Maqedoninë e Veriut sa më shpejt të jetë e mundur pas rrethit të dytë të zgjedhjeve. Kongresi do ta prezantojë raportin e tij në seancën plenare në mars të vitit 2026.

MVZ-ja e ODIHR-it përfshin 17 ekspertë në kryeqytet dhe 24 vëzhgues afatgjatë të shpërndarë anembanë vendit. Në ditën e zgjedhjeve u shpërndanë 275 vëzhgues nga 40 vende, duke përfshirë 253 vëzhgues të shpërndarë nga ODIHR-i, një delegacion 15-anëtarësh nga Kongresi dhe një delegacion 7-anëtarësh nga PE-ja. Midis vëzhguesve kishte 48 për qind gra. Hapja u vëzhgua në 109 vendvotime, ndërsa votimi u vëzhgua në 1,100 vendvotime anembanë vendit. Numërimi i votave u vëzhgua në 104 vendvotime, ndërsa nxjerrja e rezultateve në 76 KZK.

MNVZ-ja e dëshiron të falënderojë autoritetet e Republikës së Maqedonisë së Veriut për ftesën e tyre për të vëzhguar zgjedhjet, dhe Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme për ndihmën e tyre. MNVZ-ja dëshiron po ashtu të shprehë falënderimin e saj ndaj institucioneve të tjera shtetërore, partive politike, kandidatëve, mediave, organizatave të shoqërisë civile, si dhe përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare për bashkëpunimin e tyre.

Për informata plotësuese ju lutemi kontaktoni:

- Matteo Mecacci, Shef i MVZ-së së ODIHR-it në Shkup (+389 71 393185);
- Katya Andrusz, Zëdhënëse e ODIHR-it (+48 609 522266), ose Ranko Vukçević, Këshilltar për zgjedhjet i ODIHR-it, në Varshavë (+48 723 960008);
- Stéphanie Poirer, Shef i Departamentit për Mbrojtjen e Demokracisë Lokale, Kongresi (+33 65 3550710);
- Raffaele Luise, Administrator i PE-së, (+32 47 0952279).

Adresa e MVZ-së së ODIHR-it:

Georgi Dimitrov 16
1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
telefoni: +389 71 393185; e-maili: office@odihr.mk